

# ARTIZANATI NË KAVAJË DHE RROGOZHINË

RAPORT STUDIMOR



## ARTIZANATI NË KAVAJË DHE RROGOZHINË



Ky dokument është hartuar si pjesë e projektit 'Artizanët për Trashëgiminë Kulturore - ArtCult', i mbështetur nga projekti EU4Culture, i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga UNOPS në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë. Projekti zbatohet nga Instituti i Kërkimeve Urbane në bashkëpunim me Kube Studios.

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë të Institutit të Kërkimeve Urbane. Instituti i Kërkimeve Urbane nuk është përgjegjës për mënyrën e përdorimit të informacionit të këtij dokumenti.

Ky dokument mund të gjendet në formë elektronike në adresën [www.uri.org.al](http://www.uri.org.al).

Tiranë, Nëntor 2022.



# Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	3
Metodologjia	4
Turizmi dhe trashëgimia kulturore në Shqipëri	5
Kuadri ligjor dhe institucional	6
Zejtaria në Shqipëri	10
Llojet e ndryshme të zejeve	13
Zeje në zhdukje dhe rijetësimi i tyre	19
Bashkia Kavajë	21
Bashkia Rrogozhinë	26
Analiza SWOT	36
Turizmi kreativ	40
Rekomandime	44
Shtojca A: Hartëzimi	46
Shtojca B: Pyetësi	50
Shtojca C: Personat e intervistuar	54
Referencat	55



## HYRJE

Instituti i Kërkimeve Urbane në bashkëpunim me Kube Studios po zbatojnë projektin Artizanët për Trashëgiminë Kulturore (ArtCult) në Kavajë dhe Rrogozhinë, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit EU4Culture, i cili zbatohet nga UNOPS në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Kulturës.

ArtCult synon të ofrojë mbështetje për ruajtjen dhe rijetësimin e zejeve dhe aftësive artizanale të vjetra dhe në zhdukje, përmirësimin e zejeve ekzistuese si dhe inkurajimin e mënyrave të reja dhe inovative të krijimit të zanateve. Në këtë kuadër është hartuar edhe studimi me fokus te zejtaria dhe artizanët në Kavajë e Rrogozhinë. Studimi ofron informacion të përgjithshëm mbi trashëgiminë kulturore në Shqipëri, zhvillimin e traditës së zejtarisë ndër vite si dhe paraqitjen e situatës së përgjithshme të artizanëve, veçanërisht atyre që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në zonën e zbatimit të projektit, si dhe të nevojave për ndërhyrje për rigjallërimin e këtij sektori.

Studimi paraqet situatën e artizanëve dhe problematikat që ata hasin, nevojat që kanë për mbështetje dhe rekomandime mbi mundësitë për rijetësimin e trashëgimisë kulturore të Kavajës dhe Rrogozhinës. Pjesë e këtij studimi është edhe hartëzimi i artizanëve të punimeve artizanale tradicionale në këto bashki.

## METODOLOGJIA

Ky studim është hartuar mbi të dhëna të mbledhura si nga burimet parësore ashtu edhe ato dytësore. Fillimisht u krye identifikimi dhe hartëzimi i artizanëve dhe zejtarëve në zonat e targetuara nga projekti, specifikisht Kavaja dhe Rrogozhina, me ndihmën e institucioneve vendore përkatëse. Më pas, u krye një studim i literaturës për të identifikuar instrumentet ligjore kryesore të miratuara në nivel kombëtar, si dhe një hulumtim mbi historinë e zejtarisë në Shqipëri, dhe veçanërisht në zonat e projektit. Për t'u njohur më thellësisht me kompleksitetin e problematikave të zejtarëve në Kavajë dhe Rrogozhinë, dhe për të vlerësuar status quo-në socio-ekonomike të këtij grupi të synuar, u realizuan edhe takime dhe intervista me artizanët e identifikuar.

Në studimin e literaturës ekzistuese, u zbulua se mekanizmat ligjorë të dedikuar për zejtarinë dhe traditën artizanale kanë për synim nxitjen e zhvillimit të këtyre praktikave nëpërmjet mbështetjes së zejtarëve për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe mbrojtjes së interesave të zejtarëve dhe konsumatorëve të produkteve dhe shërbimeve të zejtarisë. Sidoqoftë, në nivel kombëtar, pak hapa efektive janë ndërmarrë për të adresuar kërkesat dhe nevojat e artizanëve në vend, duke bërë që kjo praktikë tradicionale të braktiset gjithmonë e më tepër.

Ky mozaik informacioni shërbeu si baza për hartimin e pyetësorit, i cili ishte instrumenti kryesor i përzgjedhur për të grumbulluar të dhëna nga komunitetet e artizanëve dhe zejtarëve të identifikuar, dhe të intervistave që u mbajtën me ekspertë të kulturorës dhe trashëgimisë kulturore në Kavajë.

Pyetjet e sondazhit u hartuan në mënyrë me synimin që të identifikonin perceptimet e artizanëve për nevojat dhe sfidat që hasin në praktikimin e punës së tyre, qasjen e tyre në tregjet fizike dhe online, aksesin në trajnime apo aktivitete të tjera ku mund të rrisin kapacitetet, shitjet dhe tendecat e konsumatorëve, dhe ekspozimin e punës së tyre te klientët nëpërmjet metodave bashkëkohore të marketimit. Pyetësori u hartua me pyetje me disa alternativa, ku pjesëmarrësit mund të zgjidhnin një apo më shumë përgjigje që reflektonin mendimet e tyre. Pyetësori (bashkëlidhur në Shtojcën B) nis me disa pyetje mbi të dhëna demografike, si mosha, gjinia, edukimi, etj. Pjesëmarrësve në studim iu kërkua më tej të ndanin informacion mbi eksperiencat e tyre praktike në ushtrimin e profesionit, metodat e përdorura nga zejtarët për të rritur vizibilitetin dhe të ardhurat e tyre, tregun dhe nevojat e tyre të paplotësuara. 21 pyetësorë u plotësuan gjatë takimeve në terren dhe telefonatave me artizanë në Kavajë dhe Rrogozhinë.

Përveç anketës, të dhënat parësore u mblodhën edhe përmes takimeve dhe intervistave me përfaqësues të Muzeut Etnografik Kavajë, përfaqësues të Bashkisë Kavajë dhe Rrogozhinë, si dhe përfaqësues të OJQ-ve të tjera që kanë në fokus trashëgiminë kulturore dhe zejtarinë dhe kanë punuar me artizanët në zonën e targetuar të projektit.

## TURIZMI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE NË SHQIPËRI

Trashëgimia kulturore është mekanizëm për të treguar dhe dëshmuar identitetin kulturor. Ajo përfshin trashëgiminë materiale dhe jomateriale, të cilat, si një tërësi kulturore, mbartin kujtesën historike dhe identitetin kombëtar, që kanë rëndësi kulturore dhe shkencore. Trashëgimia kulturore materiale përfshin ndërtesat, monumentet, peizazhet, librat, veprat e artit dhe objektet e ndryshme, ndër të tjera. Tërësia e pasurive të luajtshme e të paluajtshme që kanë interes artistik, historik, arkeologjik, arkitektonik, urbanistik, etnografik, arkivistik, bibliofilik, si edhe objekte të tjera, të përcaktuara ose parashikuara nga ligji si bartës të pasurive të qytetërimeve konsiderohet pasuri kulturore materiale. Pasuria kulturore përfshin dhe pasuri të peizazhit kulturor, që janë pjesë të territorit, karakteri i të cilave është formuar nga veprimi apo ndërveprimi i faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë, të cilat kanë interes historik, kulturor, natyror, morfologjik dhe estetik.

Trashëgimia kulturore jomateriale, njohur edhe si kultura shpirtërore, përfshin folklorin, traditat, gjuhët dhe njohuritë tradicionale, dhe pasuri kulturore jomateriale janë vlerat kulturore jomateriale, praktikat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë, krijimtarinë popullore, artizanatin dhe hapësirat kulturore që i krijojnë dhe bashkëshoqërojnë ato, të cilat, populli i pranon si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Ajo krijohet ndër shekuj e ndikuar nga mjedisi, historia, dhe ndërveprimi i shoqërive me mjedisin dhe historinë e tyre, dhe përcillet brez pas brezi, duke i dhënë individëve ndjenjën e identitetit dhe vazhdimësisë.

Trashëgimia shpirtërore përfshin krijimtarinë artistike tradicionale të një komuniteti, përmes vlerave që transmetohen gojarisht ose me mjete të tjera, të cilat në thelb pasqyrojnë kulturën dhe identitetin e pjesëtarëve të tij. Vlerat e trashëgimisë shpirtërore krijohen në lidhje të ngushtë me trashëgiminë materiale dhe etnografike të

banorëve si dhe në unitet me peizazhin që i rrethon ata. Për këtë arsye, trashëgimia shpirtërore shndërrohet në zëdhënësen e spikatur të identitetit kulturor të popujve përmes muzikës, valles, kostumeve, mjeteve tradicionale të jetesës etj.

Në trashëgiminë kulturore jomateriale ose shpirtërore bëjnë pjesë:

- Përdorimi i gjuhës në vepra letrare,
- Folklori gojor i ruajtur në kujtesë, i shkruar ose i regjistruar,
- Folklori vokal, koreografik dhe instrumental,
- Zakone dhe doke tradicionale,
- Besime dhe besëtytni të traditës,
- Zeje të ndryshme tradicionale.

Institucioni më i rëndësishëm në botë për trashëgiminë kulturore është Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO). Kjo agjenci mbron mbi 1 mijë monumente në 167 vende të botës. Për një vend të vogël, Shqipëria njihet për pasuritë e saj të shumta kulturore, natyrore, dhe shpirtërore, disa prej të cilave UNESCO i ka vendosur në listën e trashëgimisë botërore. Specifikisht, në listën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të UNESCO-s përfshihen Butrinti, Gjirokastra dhe Berati, liqeni i Ohrit, dhe lumi i Gashit dhe parku i Rrajcës. Ndërkohë iso-polifonia e së fundi edhe xhubleta janë pjesë e listës së trashëgimisë kulturore jomateriale.

## KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Ministria e Kulturës është institucioni përgjegjës për përmirësimin, konceptimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore për çështjet e sistemit të artit dhe kulturës, duke i dhënë prioritet politikave kulturore dhe investimeve në kulturë, me qëllim hapjen e perspektivave të reja për sektorin, duke kthyer kulturën në prioritet, motor zhvillimi dhe pasaportë të identiteti kombëtar.

Ministria e Kulturës, në përputhje me drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

1. Harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare te kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritit kulturor në familjen evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë;
2. Harton dhe bashkërendon punën për politikat në fushën e artit e të kulturës nëpërmjet edukimit të popullsisë, rijetësimit të vlerave dhe trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal;
3. Harton politikat, mbrojtëse dhe promovuese, për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve;
4. Harton politika për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse;
5. Udhëheq, programon dhe mbështet veprimtaritë, kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike dhe letrare, brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore dhe për krijimin e një hapësire dialogu mbarë shqiptar dhe të diversitetit kulturor;
6. Nëpërmjet strukturave të varësisë realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore;
7. Kryen funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këto përgjegjësi Ministria i ushtron përmes strukturave të saj lokale në terren, drejtoritë rajonale, zyrat e administrimit të parqeve dhe drejtoritë e muzeve, të cilat në bashkëpunim me institucionet e specializuara në varësi të saj si Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, i Monumenteve të Kulturës, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, dhe Qendra Kombëtare e



Veprimtarive Folklorike, kujdesen për mbrojtjen, mirëmbajtjen, mirë-administrimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.

Gjithashtu, një rol thelbësor për zhvillimin social dhe ekonomik vendor kanë njësitë e qeverisjes vendore të cilat kanë në administrimin e tyre një numër të konsiderueshëm të institucioneve kulturore si muze, teatro, qendra kulturore, biblioteka e galeri.

Në 2018, parlamenti miratoi ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i cili synon ndër të tjera realizimin e reformave të thella në menaxhimin e trashëgimisë kulturore dhe muzeve, decentralizimin e administrimit dhe financimit të tyre, me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, si dhe të një ndryshimi në tërësi të qasjes së shoqërisë ndaj pasurisë kulturore. Në këtë ligj me termin “artizanat” kuptohet “puna, nëpërmjet së cilës objektet e nevojshme dhe dekorative janë të punuara tërësisht me dorë dhe mjete të thjeshta”.

Në Rregulloren e Funkcionimit të Fondit të Ekonomisë Kreative të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve me “artizanat” kuptohet çdo punë që nuk kryhet industrialisht, ku përfshihen pa kufizim: produkte tekstili, druri, metali dhe qeramike, stoli, punime kashte, balte, punime në gurë dhe me gurë, punë me mjete rrethore natyrale, punime me materiale ricikluese. Po në këtë rregullore me termin “zejtari” kuptohet prodhimi artizanal i produkteve, dhe “ndërmarrje zejtare” konsiderohet ndërmarrja që ka një ose disa nga tiparet e mëposhtme:

- Procesi i punës nuk është i automatizuar në shkallë të lartë ose nuk është i ndarë në shkallë të lartë në hallka të veçanta, siç është tipike për prodhimin industrial në seri;
- Produktet prodhohen bazuar në porositë e porositësve të veçantë;
- Përpunon dhe prodhon produkte kryesisht me porosi, në seri të vogla, të cilat nuk janë karakteristikat e prodhimit industrial;
- Prodhon dhe përpunon sende prej materialeve të ndryshme dhe në formimin/krijimin e tyre shfaqet shkathtësia e prodhuesit;
- Përpunim i prodhime të veçanta personalisht nga zejtari në shtëpinë e tij ose me ndihmën e anëtarëve të familjes së tij.

Ligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” siguron mbrojtje të veçantë për produktet artizanale si pasuri kulturore me vlerë artizanale, etnografike ose historike, objektet e prodhuara në mënyrë artizanale me vjetërsi mbi 75-vjeçare dhe objektet e fabrikuar mbi 100-vjeçare.

Në vitin 2016 u miratua ligji nr. 70/2016 “Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”, i cili është ligji kryesor që rregullon ushtrimin e veprimtarisë zejtare në Republikën e Shqipërisë, kualifikimin profesional në këtë fushë, si dhe organizimin e subjekteve zejtare nëpërmjet krijimit të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë. Qëllimi i ligjit është nxitja e zhvillimit të zejtarisë nëpërmjet mbrojtjes së interesave të zejtarëve dhe konsumatorëve të produkteve e të shërbimeve të zejtarisë, si dhe mbështetja për zhvillimin e kualifikimit profesional në këtë fushë. Në këtë ligj jepen përkufizimet e mëposhtme:

**“Veprimtari zejtare”** është:

- zejtaria e shërbimit, që është mirëmbajtja dhe riparimi i stabilimenteve, linjave të prodhimit, pajisjeve e makinerive, objekteve, si dhe kryerja e shërbimeve të tjera;
- zejtaria prodhuese, që është përpunimi dhe prodhimi i produkteve për treg, që nuk kanë veçori të prodhimit industrial;
- zejtaria tradicionale, që është krijimi ose rikrijimi i objekteve të caktuara në mënyrë joindustriale, në sasi të vogla, bazuar kryesisht në punën me dorë dhe dije-bërjen e trashëguar të vendit tonë, sipas përkufizimit të pasurive kulturore jomateriale, të përcaktuara në ligjin për trashëgiminë kulturore. Këtu përfshihen artizanati dhe artizanati shtëpiak.

**“Zejtaria”** është veprimtaria ekonomike, nëpërmjet së cilës prodhohen të mira dhe/ose realizohen shërbime zejtare përmes punës me dorë ose në seri dhe, në disa raste, duke përdorur aftësitë krijuese.

**“Subjekt zejtar”** është një person fizik apo juridik, siç përcaktohet në Kodin Civil, që prodhon të mira dhe realizon shërbime zejtare, sipas listës së profesioneve në zejtari. Në veprimtarinë zejtare procesi i punës nuk është i automatizuar në një shkallë të lartë ose nuk është i ndarë në shkallë të lartë në hallka të veçanta, ashtu siç është tipike për prodhimin industrial në seri. Kjo kërkon një kualifikim zejtar të punonjësve.

**“Dhoma Kombëtare e Zejtarisë”** është personi juridik që organizohet dhe vepron sipas këtij ligji.

**“Regjistri i subjekteve zejtare”** është regjistri që mban Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, në të cilin regjistrohen personat fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtari zejtare në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**“Organet e administratës qendrore dhe vendore”** janë organet testuese dhe inspektuese të fushave të ndryshme, të lidhura me zejtarinë, që operojnë në treg, në bazë të kompetencave të përcaktuara në ligjet përkatëse.

Në ligj përcaktohet së produktet e veprimtarisë zejtare tradicionale duhet të respektojnë në mënyrë të përpiktë modelet e shpallura dhe të regjistruara si pasuri e trashëgimisë kulturore shqiptare. Shumëfishimi dhe riprodhimi i këtyre modeleve bëhet sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore. Gjithashtu spas këtij ligji, ndalohet shitja e objekteve me natyrë kulturore-artistike të importuara, në zonat e shpallura “Qendra historike apo arkeologjike”, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

## ZEJTARIA NË SHQIPËRI

Që nga koha kur njerëzimi nisi të formëzohet, është përcjellë nga puna e dorës. Artizanati është tipi më i sofistikuar i të punuarit me dorë, duke përdorur mjete të punës nga më të thjeshta. Aftësia për të prodhuar me dorë sende nga më të ndryshmet që gjejnë praktikë në jetën e përditshme, është pikërisht artizanati. Ky term zakonisht i referohet teknikës tradicionale të të krijuarit të produkteve të ndryshme, të cilat gjithmonë janë edhe shumë praktike edhe shumë estetike.

Shqipëria është e njohur për një traditë tepër të pasur të artizanatit, e krijuar prej shekujsh nga mjeshtrit popullorë, në çdo krahinë të saj. Punime në dru, hekur, bakër, alabastër, lëkurë, lesh, në materiale të çmuara si ari dhe argjendi, etj., materiale të endura apo të qëndisura, mbartin në vetvete vlera të çmuara dhe janë dëshmi e identitetit tonë kombëtar.

Sipas Enciklopedisë Shqiptare, artizanati përcaktohet si degë e prodhimit që përpunon lëndët e para bujqësore, blegtorale, pyjore e minerale me vegla të thjeshta e me dorë, duke u mbështetur sidomos te puna vetjake dhe mjeshtëria e zejtarit. Artizanati u shkëput si degë nga bujqësia e blegtoria, u zhvillua më parë kryesisht në qytet e më

pak në fshat, për të plotësuar nevojat për ushqim, veshmbathje, vegla pune, orendi e stoli, etj., dhe u ruajt pjesërisht edhe pas zhvillimit të prodhimit industrial.

Gërmimet arkeologjike në Shqipëri kanë dhënë dëshmi të shumta për zhvillimin e zejtarisë dhe nivelin e saj teknik e artistik tek ilirët e më pas tek arbëreshët e mesjetës së hershme. Në periudhën e feudalizmit të zhvilluar (shek. XIII-XV) në qendrat kryesore qytetare (Shkodër, Durrës, Berat, Prizren, etj.) kishte mbi 40 zeje, ku shquheshin përpunimi i metaleve, punimi i pëlhurave, lëkurëve, dyllit, etj.

Pas pushtimit osman të Shqipërisë, ekonomia pësoi një goditje të rëndë. Në sajë të traditave të trashëguara zejtaria dora-dorës u mëkëmb, u shtua numri i zejeve që gjallëruan jetën qytetare e tregjet lokale. Në shek. XVII-XIX rritja e kërkesave të brendshme e të jashtme për mallra i dha hov zhvillimit të zejtarisë në qendrat kryesore: Shkodër, Prizren, Elbasan, Berat, etj. Numri i zejeve arriti 80 lloje. Disa krahina u dalluan për prodhime të veçanta: Shkodra e Elbasani për prodhimin e zbukurimeve dhe armëve, Elbasani dhe Berati për argjendarinë, Korça për qilimat, Kavaja për poçarinë, Gjirokastra për bulmetin dhe opingat, etj.

Një shtresë mjeshtërish vendas me kualifikim e përvojë nisën t'i jepnin krijimeve të tyre zejtare tipare teknike dhe stilistike të veçanta dhe të një niveli të lartë. Prodhimet e kësaj periudhe përveç vlerave të përdorimit ishin njëkohësisht objekte artistike dhe shquheshin për tiparet kombëtare.

Nga gjysma e dytë e shek. XIX, zejtaria në Shqipëri nisi të binte për shkak të konkurrencës së mallrave evropiane, që qeveria osmane i lejonte të hynin lirisht. Pas pavarësisë, zejtaria plotësonte nevojat kryesore të vendit për sendet e përdorimit të përditshëm. Me politikën e dyerve të hapura të qeverisë së Zogut dhe sidomos gjatë krizës botërore (1929-1935), shumë zejtarë u rrënuan; derisa më 1938 ushtroheshin vetëm 30 lloje zejesh. Gjatë Luftës II Botërore prodhimi ra dhe u shkatërruan qindra ekonomi zejtare. Pas çlirimit, zejtaria përjetoi një ringjallje me forma moderne organizimi e prodhimi, siç ishin kooperativat e artizanatit, e më pas ndërmarrjet e artizanatit, duke vijuar në një nivel më të lartë traditat e së kaluarës.

Sipas një studimi të realizuar nga Koperacioni Teknik Gjerman në 2012, artizanati në Shqipëri numëron 281 ndërmarrje me rreth 1300 të punësuar<sup>1</sup>, nga të cilët 78% janë gra. Nga këto ndërmarrje, jo më shumë se 20% figurojnë të regjistruara si biznese. Më shumë se një e treta e këtyre ndërmarrjeve ndodhen në Shkodër dhe 15% në Korçë.

<sup>1</sup> Monitor. 2012. Pak krijues.

Dega më e madhe në artizanat i përket asaj të tekstileve, që zë 60% të totalit të punësimit. Dega e dytë më e madhe është puna e drurit, që kontribuon me 10% të punësimit brenda artizanatit.

Sot vërehet se interesi i publikut është rritur për produkte unike dhe të personalizuar; produktet artizanale kanë filluar të rigjejnë popullaritetin e humbur në treg. Kujdesi ndaj natyrës, respekti për traditën dhe vlerësimi i shprehësisë individuale të karakterit tashmë janë në modë. Një vëmendje më e madhe është parë edhe nga institucionet përgjegjëse për rijetësimin e artizanatit, nëpërmjet revitalizimit të pazareve karakteristike, ku blerës vendas dhe të huaj mund të gjejnë punime artizanale të shumëllojshme nga mjeshtërit vendas. Në qendrat e qyteteve të mëdha, si Tirana dhe Korça, janë restauruar pazaret e hershme, ku janë krijuar sheshe rekreacioni që shërbejnë kryesisht për organizimin e panairove. Tashmë artizanët kanë kontrata lehtësuese për t'u bërë pjesë e sheshit kreativ në Pazarin e Ri në Tiranë, në të cilin organizohen rreth 20-25 panairove artizanati në vit.

Interesi në rritje për produktet cilësore të prodhuara me dorë reflektohet në rritjen e numrit dhe gamës së produkteve të krijuara nga artizanët. Tregu vendas ka rritur kërkesën për produktet e punuara me dorë, duke ofruar mundësi reale për artizanët që krijojnë produkte me cilësi të lartë. Tirana është një treg i mirë për produktet artizanale për shkak të numrit të lartë të konsumatorëve potencialë, nivelit më të lartë të të ardhurave mesatare dhe ndërgjegjësimit më të lartë të konsumatorit.

Artizanët kanë filluar të riorganizohen në shoqata, në përpjekje për të organizuar veprimtari promovuese si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në Berat është ngritur Qendra e Artizanatit "Margarita", e cila ka mbledhur rreth 100 artizanë të zejeve të ndryshme -60% e të cilëve janë gra- punimet e të cilëve prezantohen në panairove brenda dhe jashtë vendit. Në Shkodër, artizanët kanë krijuar Shoqatën e Artizanëve Shkodranë. Ndër shoqatat më të njohura në nivel kombëtar janë Shoqata e Grave Profesioniste Afariste dhe Zejtare dhe Shoqata e Artizanëve Shqiptarë, të cilat janë shumë aktive në promovimin e artizanatit dhe mbështetjen e artizanëve. Shoqatat janë përpjekur të inkurajojnë forcimin e partneritetit midis sektorëve publikë dhe privatë, dhe janë nismëtare për organizimin e eventete dhe panairove të ndryshme në mbështetje të artizanëve në të gjithë Shqipërinë.

## LLOJET E NDRYSHME TË ZEJEVE

Përmes projektit “Rrënjët e mia - Kulturë 360”, zbatuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, me bashkëfinancim të Ministrisë së Kulturës, është evidentuar fuqia e artizanatit shqiptar për të sfiduar kohën dhe ruajtur origjinalitetin në veprimtari të ndryshme zejtare, paraqitur si në vijim.<sup>2</sup>

### PUNIMI I GURIT

Gdhendja e materialit shkëmbor, gur dhe mermer, është një nga mjeshtëritë më të vjetra të njerëzimit. Relievi kryesisht malor i trojeve shqiptare ofron me bujari material për mjeshtërit e gurit.

Krahinat më të njohura në Shqipëri për mjeshtëri në gdhendje janë Mokra, Opari, disa krahina të Matit e të Dibrës, por jo vetëm. Nga duart e mjeshtreve shqiptarë gurskalitës janë punuar kolonat dhe muret e kalave që mbartin historinë dhe frymëzuan legjendat, urat rezistente të gurit që kanë bashkuar brigjet e lumenjve duke lidhur banorët e zonave përreth, rrugicat me kalldrëm dhe shtëpitë e gurta fisnike, ujësjellësit, dekoret e gurta që hijeshonin portat dhe dritaret, ndërtesat e kultit që kanë sfiduar kohën, pllakat e mbishkrimeve mbi porta dhe skulpturat e heshtura, deri edhe sende të përdorimit të përditshëm dhe suvenire të ditëve të sotme. Falë mjeshtërisë së gurskalitësve shqiptarë ndër shekuj, qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës u regjistruan si Trashëgimi Botërore nga UNESCO në vitin 2005.

Kjo mjeshtëri sa e veçantë aq edhe e vështirë, karakterizohet nga vlerësimi brezar, që e trashëgon këtë aftësi si pasuri të vyer. Një shembull dinjitoz përfaqësimi është vepra e Gëzim Hidrit, i cilësuar si “Skllav i gurit” për nga përkushtimi dhe pasioni personal, që është ekspozuar në Venecia, Athinë dhe Londër, duke lartësuar krahas emrit të tij edhe vendin e prejardhjes.

### PUNIMI I ARGJILËS - POÇARIA

Mjeshtëria e punimit të baltës në Shqipëri, zë fill që në neolitin e hershëm, me gjetje të shumta në gjithë territorin e vendit. Lulëzimi që njohu poçaria në periudhën antike nuk u shfaq dukshëm në etapat e mëvonshme sepse vendin e enëve prej balte filluan ta zënë ato prej metali, qelqi dhe në disa raste edhe ato prej druri. Megjithatë, mjeshtëria e poçarisë në krahasim me mjeshtëritë e tjera karakterizohet nga jetëgjatësia. Kjo

---

<sup>2</sup> Rrënjët e mia. 2021.

jetëgjatësi shpjegohet me disa veti fizike të veçanta që kanë enët e baltës, p.sh. në to uji ruhet i ftohtë, disa lloj ushqimesh konservohen më mirë dhe pa erë dhe shpesh edhe disa gatime bëhen më speciale.

Në vendin tonë deri në gjysmën e dytë të shekullit të XX-të ende ekzistonin disa qendra, ku ushtrohej mjeshtëria e punimit të enëve tullave dhe tjegullave prej balte. Sipas studiuësve, në Shqipërinë Veriore, më të përmendur ishin fshatrat Gojan (Pukë) dhe Gërman (Mat). Në Shqipërinë e Mesme, qendra të tilla vazhdonin të ekzistonin në fshatin Farkë (Tiranë) dhe në qytetin e Kavajës. Ndërsa në pjesën jugore të vendit, më të dëgjura në punimet e baltës ishin fshatrat Bradvicë, Vërlen e Grapsh në rrethin e Korçës. Poçarët e fshatrave Gojan (Pukë) e Gërman (Mat) njiheshin më shumë për punimin e enëve për përgatitjen e ushqimit, ashtu si edhe ato të fshatit Farkë (Tiranë). Ndërsa poçarët e qytetit të Kavajës dhe ato të fshatrave Bradvicë e Vërlen (Korçë) u bënë të njohur më shumë për punimin e enëve të ujit, bulmetit, të ngrënies dhe enëve për mbajtjen e pijeve dhe glikove tradicionale.

Në përgjithësi, qendrat e punimit të enëve prej balte, krahas atyre të prodhimit të tullave dhe tjegullave, kishin prodhimtari të madhe dhe të vazhdueshme. Ato plotësonin më së miri nevojat e përditshme për enë dhe objekte të tjera, në mënyrë të veçantë për shtresat e varfëra dhe të mesme të popullsisë, e sidomos në fshatra fushore, ku mungonte lënda e drurit, me të cilën punoheshin një pjesë e mirë e enëve. Por, përveç enëve të kuzhinës, poçarët shqiptarë janë marrë edhe me punimin e objekteve të tjera, si lodra fëmijësh, tuba oxhaqesh, mjete ndriçimi, materiale ndërtimi, etj. Për vlerat praktike dhe ergonomike që kanë enët prej balte, kjo mjeshtëri kultivohet edhe në ditët e sotme dhe prania e prodhimeve të saj në mjediset familjare dhe sociale vijon të jetë e mirëpritur. Poçaria e Farkës është një shembull inkurajues i vlerësimit njerëzor dhe përkushtimit qytetar ndaj traditës.

## PUNIMI I METALEVE

### PUNIMI I HEKURIT, BRONZIT DHE BAKRIT

Punimi i metaleve, një nga mjeshtëritë më të vjetra të njerëzimit, është mjaft i përhapur edhe në Shqipëri. Mjeshtërit e metaleve kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin e shoqërisë falë punës së tyre për prodhimin e mjeteve të punës bujqësore, veshjeve të kuajve, orendive shtëpiake, por, në periudha të vështira historike, edhe armëve dhe parzmoreve.

Teknikat e përdorura kanë qenë kryesisht ato me derdhje dhe farkëtim. Në ditët e sotme ky art ka marrë të tjera përmasa. Përpos funksionalitetit, punimet metalike sot përdoren gjerësisht për qëllime dekorative dhe kanë trajta e motive nga më të ndryshmet, ku përmendim kangjellat florale të banesave, ndriçuesit, portat me simbole mitike apo motive të faunës, shtretër, tryeza të kombinuara me materiale të tjera natyrore si dru dhe mermer, etj.

### ARGJENDARIA

Krijimi i stolive në përgjithësi apo i stolive identifikuese, si kurorat, në veçanti është një nga mjeshtëritë bashkëshoqëruese të njeriut që në kohë shumë të hershme. Përpunimi i metaleve si bronz, bakër, argjend dhe flori për krijimin e stolive është një zëjtari elitare, për shkak të mjeshtërisë artistike dhe finesës së proceseve. Një stoli nuk tregon vetëm një histori por edhe orë të gjata pune, frymëzim artistik dhe përkushtim. Mjeshtëria popullore e përpunimit të metaleve gjithmonë është frymëzuar nga e bukura. Qendra të njohura për zhvillimin e kësaj mjeshtërie kanë qenë Shkodra, Elbasani, Berati, Gjakova e Prizreni, ku prodhoheshin stoli të ndryshme (vathë, unaza, varëse, gjerdanë, byzylykë, breza, qostekë apo armë të zbukuruar, orendi, kuti tualeti, tabaka, zarfe filxhanësh, kuti cigaresh, etj.) Mjeshtërit argjendarë shqiptarë prodhonin krijimet e tyre me teknika të ndryshme pune, duke punuar me skalitje, me rrahje, me derdhje, me filigran, etj.

### FILIGRANI

Përpunimi i metaleve me teknikën e filigranit të tejdukshëm, që quhet ndryshe qëndistaria e argjendit, është një nga mjeshtëritë më përfaqësuese të trevave shqiptare. Ndër shekuj, finesa dhe bukuria e punimeve me filigran ka tërhequr vëmendje, duke qenë se brishtësia dhe delikatesa e këtyre punimeve kërkon një përkushtim, saktësi dhe përqendrim të pashtershëm artistik. Në ditët e sotme punimet shqiptare të filigranit zënë një vend të posaçëm në tregun e turizmit artizanal, me suvenire elegante që janë simbol i një prej mjeshtërive më delikate të krijuara nga duart e mjeshtëreve shqiptarë.

### PUNIMI I DRURIT

Natyra i ka falur vendit tonë kurora të gjelbra që gëzojnë veti të shumëllojshme të lakmuara nga mjeshtrit e drurit. Pyjet e pishave, ahut, vidhit, lisave, arrave dhe ullinjve shekullorë kanë shërbyer si parajsë ushqyese e shpirtit artistik, duke zhvilluar dhe shndërruar mjeshtërinë e gdhendjes së drurit në një traditë mbresëlënëse për nga cilësia dhe larmia e mjeshtërisë.



Zanafilla e kësaj mjeshtërie i atribuohet barinjve, të cilët krijojnë veglat që i nevojiteshin, si kërraba dhe fyelli, por edhe orendi të tjera, si furka për tjerren e leshit, sëndukë, djepe, etj., të cilat i zbukuronin me elemente të florës dhe faunës shqiptare dhe simbole të mitologjisë popullore. Nevoja për këto sende druri dhe dekorime banesash bëri që kjo mjeshtëri të kthehej në profesion. Krahina të ndryshme nisën të njiheshin për punimet mjeshtërore të tavaneve, ballkoneve dhe portave, ikonostaseve, sëndukëve, orendive shtëpiake, djepeve apo veglave muzikore, ndërsa artizanët dibranë, beratas, koniciotë, ata nga Gryka e Madhe, Golloborda e Reka, Tetova e Çermenika nisën të dallohen për mjeshtëritë e tyre. Zbukurimet e drurit në ikonostaset e vendeve të kultit, të cilat karakterizohen nga tejshpime dhe perfeksion artistik, kanë ardhur deri në ditët e sotme si aset unik i trashëgimisë kulturore, ku përmendim ikonostaset e Beratit, Korçës, Erindit, Leusës dhe Sopikut, ndër të tjera.

Mjeshtëria artistike e punimit të drurit shpaloset edhe në krijimin e veglave muzikore me tela. Nga duart e mjeshtërve shqiptarë dolën vegla muzikore të shquara për elegancë dhe bukuri si çiftelia dhe lahuta të punuara në Malësi të Madhe. Nga fundi i shek. XIX mjeshtëria e punimit të drurit u përqaftua edhe nga Tirana, Elbasani, Shkoderë, Prizreni e Gjirokastra. Për skalitjen e drurit, në varësi të kohës, objektit të synuar, motivit dhe materialit drusor, përdoren vegla të ndryshme, si thika e lima, por edhe mjete gjysmë të mekanizuara, si çarku. Nisur nga larmia e krijimtarisë, mjeshtërit shqiptarë të gdhendjes së drurit mund të konsiderohen skulptorë artistë të tij.

Krahas punimeve tradicionale të drurit, kohët e fundit është mjaft e pëlqyer edhe teknika e pirografisë, që është vizatimi ose shtypja e një modeli duke djegur sipërfaqen e drurit. Duke përdorur një hekur pirografi ose një mjet të nxehtë mbi faqen e drurit, pirogravori shfaq pamjen me anë të djegies në vendet e dëshiruara ose edhe e kombinon gravurën e tij me gdhendje.

### **PUNIMI I FIJES - QËNDISTARIA**

Punimi i leshit e pambukut me endje dhe qëndistaria janë mjeshtëri tradicionale përfaqësuese të trevave shqiptare. Gruaja shqiptare e trashëgonte mjeshtërinë që në moshë të hershme si aftësi profesionale dhe mënyrë për të siguruar të ardhura e të mira materiale. Proceset e përpunimit të leshit, kombinimet e ngjyrave, motivet e larmishme pasqyrojnë fantazinë artistike femërore.

Veshjet tradicionale, veshjet dimërore me thurje, të linjtat, mbulesat, perdet, jastëkët, çentrot, qilimat, sixhadet dhe velenxat ishin punime që siguroheshin nga duart e arta

dhe puna e palodhur e grave shqiptare. Ajo që fillimisht konsiderohej si detyrim familjar për gratë, shpejt kthehej në pasion të vërtetë që i shoqëronte gratë përgjatë jetës. Produktet e avlëmendit, thurjes dhe qëndistarisë karakterizohen nga origjinaliteti, rezistenca, cilësia e lartë ergonomike, por edhe nga bukuria që ofrojnë kombinimet e ngjyrave dhe motiveve.

Qëndistaria ka luajtur një rol të çmuar në pasurimin e veshjeve folklorike të të gjitha krahinave dhe, nëpërmjet elementeve përfaqësues, ka kontribuar në krijimin e identitetit krahinor. Ndërkohë, përpunimi i leshit për prodhimin e shajakut është një nga traditat mjeshtërore më të hershme, dhe veshjet si xhubleta apo plisi e pasqyrojnë më së miri këtë teknikë. Xhubleta, një veshje e njohur botërisht dhe e mbrojtur nga UNESCO, dallohet për formën e veçantë me një valëzim fundor dhe zbukurimet me motive dhe ngjyra të plota por shumë të zgjedhura, si p.sh. kombinimi i ngjyrës së zezë me vjollcën ose blunë. Plisi, ose qeleshja, është një tjetër veshje prej shajaku. Kjo veshje e kokës për burrat është një trashëgimi nga lashtësia e hershme dhe përfaqëson një lidhje simbolike mes bardhësisë së saj dhe nderit të burrit, duke lartësuar kështu figurën burrërore shqiptare.

## PUNIMI I QELQIT

Qelqi si material ka ekzistuar në natyrë i krijuar nga përzierja e gurëve në temperatura tepër të larta, kryesisht pas shpërthimeve vullkanike. Bëhet fjalë për qelqin vullkanik (Obsidian) që është një material opak i errët, i përdorur qindra vjet më parë për prodhimin e bizhuterive, poçeve, pjesëve të veglave të punës dhe të armëve.

Prodhimi i qelqit mendohet se e ka zanafillën rreth 7000 vjet më parë dhe Babilonasi i ish-in të parët që e prodhuan. Në historinë e antikitetit, Pliny dhe Elder, ishte dëshmitari i parë i zbulimit të mënyrës së prodhimit, pavarësisht "rastësisë" që ndodhi nga përzierja e sodës me rërën nën temperaturën e lartë të zjarrit të ndezur nga ekuipazhi i një anijeje tregtare.

Bukuria e qelqit, e kombinuar me cilësitë e tij të vyera si tejdukshmëria, shkëlqimi, fortësia dhe higjiena, e kanë bërë atë mjaft të kërkuar ndër vite dhe e ka shndërruar në një prej materialeve që ndërthuret me shumë materiale të tjera duke zgjeruar përdorimin e tij në plotësimin e çdo funksioni.

Qelqi mbetet mjaft shprehës edhe në krijimet artistike. Në vendin tonë tërheqja ndaj tij në mënyrë të organizuar ka filluar në vitin 1970 me hapjen e fabrikës së parë të qelqit

në Kavajë, ku punonin 1,200 persona. Fillimisht fabrika prodhonte kryesisht linjat e xhamit të ambalazhimeve, dhe më pas u zgjerua për të përfshirë prodhimet e artikujve shtëpiake, dekorative dhe qelqit laboratorik.

Veçoria e ndërthurjes së brishtësisë me forcën, transparencës me ndarjen, hapësirës me kufizimin, e ka shquar qelqin si material tërheqës për artistët, të cilët, duke zbatuar teknika të ndryshme përpunimi të silicit si shkrirjen, vitrazhin, përzierjen dhe tretjen e ngjyrave, i kanë zgjeruar dhe lartësuar vetitë e qelqit në vepra artistike. Dekorimi i qelqit është pjesë e zejtarisë artistike me rezultate të larmishme në zbukurimin e objekteve prej qelqi, duke qenë se nga dekorimi i pasqyrave, gotave, vazove, shisheve, kavanozave, xhamave, etj. artizanët krijojnë vepra artistike të mirëfillta.

## PUNIMI I KASHTËS

Bimësia është përdorur si lëndë e parë për plotësimin e nevojave të ndryshme të njeriut prej shekujsh në trevat shqiptare, ku kashta që përftohej nga tharja e barërave, përzihej me baltë, dhe shërbente si material mbushës në ndërtimin e banesave të qerpiçit. Disa lloje bimësh drusore, si thupra, shelgu, shtogu dhe panja, janë elastike dhe rezistente në përthyerje, prandaj kanë shërbyer dhe vijojnë të përdoren për thurjen e produkteve të ndryshme, si çanta, shporta, kosha, vazo, karrige, tavolina, ndenjëse, çadra plazhi, etj., Gjithashtu, këto bime drusore përthithin mirë bojën, duke mundësuar larmi jo vetëm në forma dhe funksione, por edhe në ngjyra.

Mjeshtëria e thurjes së bimëve u zhvillua si ndërmarrje kolektive pas vitit 1963 kryesisht në Kukës, ku filloi të funksiononte një ndërmarrje artizanati e madhe, me mbi 1000 punëtorë në qytet dhe 200 në fshatra, kryesisht në Bicaj. Kjo ndërmarrje punonte e orientuar drejt eksportit dhe krijonte punime të ndryshme artistike e funksionale si shporta, mobilje verandash, stola, rafte, veshje shishesh, etj.

Në ditët e sotme prodhimi i këtyre punimeve artistike është reduktuar për shkak të zvogëlimit të sasisë së lëndës së parë, rritjes së importit të orendive të ngjashme prej bambuje si edhe çmimeve konkurruese të produkteve të importit. Sot, artizanët shqiptarë të punimit të kashtës i gjejnë kryesisht në Shkodër (orendi shtëpiake), Elbasan (shporta dhe kosha) dhe Durrës (çadra plazhi). Për shkak të interesit në rritje për produkte ekologjike, produktet artizanale të kashtës janë mjaft të preferuara nga të gjithë ata që mbrojnë mjedisin dhe vlerësojnë natyrën.

## ZEJE NË ZHDUKJE DHE RIJETËSIMI I TYRE

### OPINGARËT

Punimi i opingave është ndoshta zejtaria më e hershme dhe më e përhapur, dhe zanafilla i dedikohet nevojës dhe domosdoshmërisë për të krijuar veshje mbrojtëse për këmbët. Opingarët ishin ndër zejtarët më të kërkuar për shekuj me radhë në thuajse të gjithë Ballkanin. Provat arkeologjike më të hershme të opingave datojnë rreth shekullit të IV-V p.e.s. Dëshmi të mëvonshme i referohen Onufrit (shek. XVI) dhe veprave të tij ikonografike, ku shpesh shohim opinga.

Etimologjia e fjalës “opinga” i referohet fjalës së vjetër të gjuhës shqipe *api* që në ditët e sotme shqiptohet hapi. Fjala “opinga” është përmendur në 1610 nga Marino Bizzi, një aristokrat i njohur Venecian në Dalmaci, Kryepeshkop i Antivarit, i cili përmend në shkrimet e tij se “burrat e krahinës së Mirditës vishnin opinga, të përgatitura nga ata vetë me lëkurë lope”. Opingat karakterizoheshin nga prakticiteti, elasticiteti dhe qëndrueshmëria. Opingat më të thjeshta krijoreshin me një copë të vetme lëkure, buzët e së cilës rudheshin me retra lëkure duke u afruar pas këmbës dhe shtrëngoheshin me gjalma prej leshi. Variante të tjera punimi përfshijnë opinga me lëkurë lope, me retra, me gjuhëzë, me përkresa, me tufëza, me xhufka, me prroqe, etj. Procesi tipik i krijimit fillonte me përpunimin e lëkurës, prerjen sipas kallëpeve, ngjitjen dhe qepjen e shtresave dhe përfundonte me zbukurimin me elemente dekorative. Elementet dekorative me të cilat artizanët zbukuronin opingat ishin gjalma dhe xhufkat për opingat e burrave dhe qëndisimat për ato të grave.

Duke qenë veshje tradicionale e përdorur gjerësisht në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mali të Zi, Greqi dhe në fshatrat arbëreshë, opingat mbartnin elemente identifikues krahinorë. Specifikisht, artizanët e krahinave të veriut krijonin opinga me majë paksa të rrumbullakët dhe me gjalm, kurse opingat e përdorura në krahinat e jugut kishin majë të ngritur dhe xhufka. Në periudhën osmane, artizanët opingarë të Përmetit kishin ekskluzivitetin e tregtimit të opingave në shumë vilajete osmane, përfshirë Shkodrën dhe Janinën, deri më 1841, kur ky privilegj u cungua nga reformat e Tanzimatit. Zhvillimet e fundshekullit XVIII e në vijim ndikuan negativisht në prodhimin artizanal në përgjithësi dhe punimin e opingave specifiku. Opingat u zëvendësuan gradualisht me veshje të tjera për këmbët duke zbehur deri në zhdukje nevojën për këtë zejtar.

### *Mundësitë e rijetësimit*

Pavarësisht se opingat nuk janë më domosdoshmëri, punimi i tyre mbetet një nga zejtaritë tradicionale më të pasura me elemente të krijimtarisë artistike. Mundësitë e rijetësimit të kësaj zejtarie mund të përfshijnë bashkëpunime dhe partneritete që kanë në fokus kombinimin e punimit artizanal tradicional me prezantimin artistik bashkëkohor, të plotësuar me informacionin historik përkatës. Krijime të tilla do të kontribuonin në pasurimin e fondit të krijimtarisë artistike dhe përcjelljen e tradicionales në një dimension të ri artistik.

## **NALLBANXHINJTË DHE SAMARXHINJTË**

Nallbanxhinjtë ishin zejtarët që mbathnin kuajt me patkonj. Në kohët e hershme, kur kuajt ishin pjesë integrale e së përditshmes si mjet transporti dhe pune, ky zanat ishte mjaft i kërkuar. Samarxhinjtë ishin zejtarët që prodhonin dhe tregtonin shala për kuajt dhe kafshë transporti. Samari, një punim druri i lakuar që shërbente për lidhjen e litarit, vendosej mbi kurrizin e kafshëve për transport. Shala e kalit krijohej me dru dhe lëkurë dhe karakterizohej nga një punim më fin dhe i ndërlikuar. Industrializimi i ekonomisë pati një ndikim të drejtpërdrejtë tkurrës në këtë zejtar, kafshët e transportit u zëvendësuan nga automjetet, dhe sot këto zanate shihen të destinuara të humbasin.

### *Gjallërimi dhe rijetësimi*

Disa mënyra efikase për gjallërimin dhe rijetësimin e këtyre zejtarive mund të jenë iniciativat turistike të bazuara në traditë, si shëtitjet dhe turet me kuaj, nxitja e investimeve për krijimin e qendrave të hipizmit, dhe punimin e tyre në miniatura të ekspozuara në kuti xhami si suvenire, etj.

## **KALLAJXHINJTË**

Kallajisja është procesi i pastrimit, rërimit, drejtimit dhe lyerjes me kallaj të sendeve prej bakri. Kjo zejtarë lidhej ngushtë me përdorimin e enëve të bakrit, këmborëve dhe këmbanave, të cilat duheshin kallajisur shpesh. Kallajxhinjtë ishin kryesisht zejtarë shëtitës që lëviznin fshat më fshat me materialin e mjetet e punës dhe ofronin shërbim në çdo shtëpi. Dikur ishin shumë të kërkuar pasi sendet e përdorimit të përditshëm, si pjatat, tenxheret, tepsitë, kazanët e pjekjes së rakisë apo zierjes së reçelit, bëheshin prej nga bakri, por zhvillimi ekonomik, globalizimi dhe risitë në prodhim për nga materiali, karakteristikat ergonomike, forma dhe ngjyrat, sollën zëvendësimin e enëve të bakrit me enë alumini dhe qelqi, duke zbehur kërkesën për kallajisje.

### *Gjallërimi dhe rijetësimi*

Për të promovuar gjallërimin e kësaj zejtarie, duhet të rikthejmë vëmendjen në promovimin e traditës artizanale të punimit të enëve prej bakri, si pjatancat, vazot, gjymat, këmborët e bagëtive dhe këmbanat e vendeve të kultit. Zejtarët e bakrit i kanë pasuruar këto enë me gdhendje motivesh apo elemente dekorative të trashëguara nga modele antike. Artistët dhe disenjatorët e rinj mund të luajnë rol të rëndësishëm në procesin e rijetësimit afatgjatë duke i inkorporuar këto elemente në punën e tyre, apo duke i sjellë më pranë konsumatorëve nëpërmjet modernizimit dhe promovimit në forma bashkëkohore. Gjallërimi nuk konsiston në rikthimin e produkteve tradicionale në përdorimin e përditshëm, por në ruajtjen e praktikave tradicionale dhe ekspozimit të tyre në dritën e së tashmes.

## BASHKIA KAVAJË

### PROFILI

Kavaja kufizohet në veri nga bashkia Durrës, në lindje nga bashkia Tiranë, në jug nga bashkia Rrogozhinë dhe në perëndim nga deti Adriatik. Bashkia përbëhet nga pesë njësi administrative dhe qendra e saj është qyteti i Kavajës. Me sipërfaqe prej 198.81 km<sup>2</sup>, Bashkia e Kavajës shtrihet në një zonë kodrash të buta dhe fushash pjellore përreth qytetit të Kavajës deri në detin Adriatik, ku gjenden plazhe pjesërisht ranore dhe pjesërisht shkëmbore. Qyteti i Kavajës zë gjysmën e popullsisë së njësisë së re, ndërsa njëra nga dy njësitë administrative bregdetare, Golemi, është ndërtuar gjatë viteve të fundit për shërbime turistike, duke u larguar nga bujqësia. Sipas Censurit të vitit 2011, Kavaja ka një popullsi prej 40,094 banorësh dhe densitet prej 201 banorë/km<sup>2</sup>, ndërsa sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 79,445 banorë, me densitetin 400 banorë/km<sup>2</sup>.

### HISTORIKU

Studiues të ndryshëm, deri vonë kishin mendimin se zanafilla e Kavajës si qendër e banuar duhej kërkuar diku nga mesi i shekullit XVI. Por duke u mbështetur në zbulimet e disa fragmenteve arkitekturore dhe në disa mbishkrime, del se zanafilla e këtij vendbanimi duhet parë deri në shekujt e parë p.e.s, nga gjetja në kalanë e Zig-Xhafajt

në atë kohë e quajtur “Arnisa”, që i përket shekujve IV-II p.e.s<sup>3</sup>. Nga këto zbulime arrihet në përfundimin se në Zig-Xhafaj, gjatë këtyre shekujve, ka ekzistuar një qytezë ilire e tipit kështjellë që shërbente si vendbanim, qendër administrative e fetare, si dhe vend strehimi për banoret e zonës në raste luftërash.

Për herë të parë emri i Kavajës u përmend në shekullin XV. Në atë kohë, Kavaja, që shkruhej Kavalje, shtrihej në rrugën e njohur tregtare romake Via Egnantia që vazhdon në Durrës dhe Elbasan. Sipas studimeve, qyteti e ka emrin Kavajë nga emërtimi i fshatit Kavalje dhe i territorit të tij të gjerë. Në dy regjistra osmanë të viteve 1431 dhe 1583, për fshatin Kavalje dhe për qendrat e banuara përreth tij jepen të dhëna mbi numrin e banesave (familjeve) të çdo fshati dhe mbi të ardhurat që mblidheshin nga qeveria e atëhershme si taksa. Gjatë shekullit të XVII dhe XVIII, Kavaja përjetoj një lëvizje të madhe administrative dhe u bë qendër tregtare; në dallim me Durrësin, qyteti pati dyfish më shumë shtëpi, të cilat u shkatërruan në shekullin XX, si pasojë e luftërave dhe ndryshimeve infrastrukturore.

## KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE TË BASHKISË KAVAJË

Bashkia Kavajë shtrihet në afërsi të poleve më të mëdha ekonomike në vend (Durrësi dhe Tirana), të cilat i japin Kavajës një potencial ndërveprimi dhe zhvillimi ekonomik dhe industrial. Klima mesdhetare dhe karakteristikat gjeologjike ofrojnë mundësi zhvillimi për bujqësinë dhe blegtorinë. Afërsia me detin Adriatik, peizazhi bujqësor dhe tradita përbëjnë një potencial të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të turizmit. Në Bashkinë e Kavajës janë regjistruar rreth 1,631 biznese, prej të cilave më shumë se 82% janë biznese të vogla, që operojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

### *Sektori i shërbimeve dhe i turizmit*

Sektori i shërbimeve dhe turizmit është një sektor tejet i rëndësishëm i cili përqëndrohet kryesisht në bashkinë Kavajë dhe njësinë administrative Golem. Turizmi përbën një potencial të lartë zhvillimi për shkak të pasurisë kulturore dhe natyrore që karakterizon zonën. Megjithëse vitet e fundit sektori turistik ka patur zhvillim, ende ndjehet mungesa e cilësisë dhe larmisë së shërbimeve, mungesa e përthithjes së turizmit afatgjatë dhe mungesa e orientimit të ofertës drejt kërkesës së tregut. Për këtë arsye, nevojitet zhvillimi i mëtejshëm dhe cilësor i strukturave akomoduese dhe shërbimeve, promovimi dhe ndërlidhja me agro-turizmin dhe turizmin kulturor, për të synuar një turizëm afatgjatë cilësor dhe atraktiv.

---

<sup>3</sup> Lazi, 2021. Kavaja: Historia, Kultura, Turizmi. Albanian CRI.

## KARAKTERISTIKAT SOCIALE TË BASHKISË KAVAJË

Në Bashkinë Kavajë, 1,079 familje janë përfitues të ndihmës ekonomike<sup>4</sup>. Përqendrimi më i madh (73%) i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike (NE) është në njësinë administrative Kavajë; ndërsa 27% e familjeve përfituese jetojnë në 4 njësitë e tjera.

### *Punëkërkues të papunë*

Sipas të dhënave të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në Bashkinë Kavajë janë të regjistruar 3,167 punëkërkues të papunë, 53% e të cilëve janë gra. Rreth 61.2% e punëkërkuesve të papunë janë mbi 40 vjeç. ndërsa 37% i përkasin grupmoshës 20-40 vjeç. Të dhëna të tjera tregojnë se punëkërkuesit e papunë janë: 15.3% romë/ egjiptianë, 8% gra kryefamiljare dhe 0.97% emigrantë të kthyer.

## TRADITË DHE KULTURË

Kavaja ka një traditë të pasur të artizanatit, nga epoka e bronzit deri tek qytetërimi ilir, arti dekorativ dhe figurativ u shtrinë në artizanatin ilir, dhe qeramika e pikturuar dëshmon për aftësitë artistike të artizanëve ilirë. Kjo traditë vazhdon deri në ditët tona me punimet artistike të poçerëve kavajas.



Fig. Tradita e pocarisë në Kavajë (punime nga L. Kostrista)

Qëndistaria është një tjetër zeje e përhapur në zonën e Kavajës, që është trashëguar nga brezi në brez deri në ditët e sotme. Duke përdorur një mori mjetesh e materialesh, si pe, fije, pambuk, lesh, fije lini, bojë, gjilpëra, grep, shtiza, çakmak, astar, pëlhura, rruaza, etj, artizanët zbukurorin me qëndisje në mëndafsh, ar dhe argjend kostumet popullore.

<sup>4</sup> Plani Social Bashkia Kavajë 2018, Save the Children.






Fig. Tradita e endjeve dhe thurjeve në Kavajë (punime nga L. Krasnaj)

Tezgjahu në Kavajë është një mjeshtëri dhe art me vlera historike dhe kulturore të veçanta, jo vetëm për zonën po për të gjithë Shqipërinë. Ai është gjithashtu burim të ardhurash për shumë gra nga Kavaja, të cilat kryesisht e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kushte jo të formalizuara. Gratë artizane të intervistuar shprehen se lëndën e parë, fijet e leshit, i marrin në Vlorë, ku mbarështohen dele që janë burim për lesh të cilësisë së lartë. Deri në fazën përfundimtare të thurjes në tezgjah, leshi kalon disa procese pune, siç janë prerja, larja dhe tharja e leshit, tjerrja e perit, ngjyrosja, dredhja, larja dhe tharja e perit, prerja e perit, endja dhe kalimi i perit në shpat dhe së fundi thurja në tezgjah.




Fig. Tradita e punës në tezgjah në Kavajë (punime nga L. Hoxha)

Traditë e lashtë në zonën e Kavajës kanë qenë dhe punimi i filigranit argjend e bakër<sup>5</sup>. Një nga aktivitetet e veçanta ka qënë prodhimi i bizhuterive prej filigrani, veprimtari të cilat nuk vërehen të jenë aktive në ditët e sotme. Po kështu, tradita e punimit të gurit, sidomos i alabastër, apo gdhendja dekorative në dru, veçanërisht i llullave shumëgjyreshe dhe pjatave dekorative, duket të jetë zbehur me kalimin e viteve, duke mos arritur të trashëgohet nga njëri brez në tjetrin.

## TURIZËM

Vitet e fundit, Kavaja regjistron sezone të suksesshme turistike. Mijëra turistë të huaj dhe vendas zgjedhin plazhet e bregdetit të Kavajës për të pushuar, të cilët shtrihen nga Përroi i Agait deri te Plazhi i Gjeneralit. Ndërkohë që një pjesë e tyre vizitojnë dhe qytetin për të njohur historinë dhe traditat e Kavajës.

Muzeu etnografik i Kavajës, i kompletuar në vitin 1971, u ngrit në një ndërtesë me një hajat, tipi i së cilës ishte i përhapur gjerësisht në shekullin e XVIII-të. Origjina e saj arkitektonike daton që nga antikiteti i vonshëm, në tipologjinë e një *villa rustica*, shpesh e pranishme në rajon. Veprat artizanale të krijuara në qeramikë, bakër dhe tekstil nga artizanë vendas, që përfaqësojnë qytetin dhe rajonin, janë të ekspozuara në muze, së bashku me një koleksion të gjerë punimesh nga rajonet e veriut, verilindjes dhe jugut të Shqipërisë. Elementet e veshjeve tradicionale nga këto rajone dallohen për nivelin e lartë të mjeshtërisë dhe finesës, për pasurinë e zbukurimeve dhe simboleve të shkruara në forma gjeometrike, zoomorfe dhe antropometrike.

Xhamia historike "Kubelie", portiku i saj dhe kulla 200-vjeçare e Sahatit, janë disa nga elementët tërheqës të qytetit të vogël, që mbart plot dëshmi të një historie që shtrihet deri në antikitet. Këtu mund të gjejnë gjurmët e një vendbanimi të lashtë të fisit ilir të Taulantëve, për të vijuar me gjurmët e rrugës "Egnantia".

Një nga pikat turistike që tërheq shumë vizitorë është dhe Kisha e Shën e Premtes, e cila gjendet në fshatin Çetë të Komunës Helmës, shumë pranë qytetit të Kavajës. Ajo është e njohur për dy pelegrinazhet e mëdha, atë të 25 korrikut dhe 15 gushtit, dhe është shpallur monument kulture në vitet 60-të.

Në qytetin e Kavajës, por edhe rreth tij, gjenden mjaft monumente natyrore, që ia vlen të vizitohen, dhe që vitet e fundit tërheqin mjaft vizitorë të huaj e vendas. Në vitin 2002, territore të ndryshme në zonën e Kavajës u shpallën "Monumente të natyrës".

---

<sup>5</sup> Lazi, 2021. Kavaja: Historia, Kultura, Turizmi. Albanian CRI.

Ato shtrihen përgjatë gjithë territorit të Kavajës, dhe janë të vizitueshëm, ndërsa përbëjnë një domosdoshmëri për t'u parë nga pushuesit. Monumente të natyrës u shpallën fosilet detare të Thartorit, burimet sulfurore të Fliballijes, burimet e kripura të Golemasit, masivi me dafina i Kalasë së Turrës (në plazhin e Spillese), etj.

## BASHKIA RROGOZHINË

### PROFILI

Bashkia Rrogozhinës shtrihet në një terren pjesërisht kodrinor dhe fushor deri në bregun e detit. Rrogozhina kufizohet në veri me Bashkinë Kavajë, në veri-lindje me Bashkinë Tiranë, në jug me Bashkinë Lushnje dhe Divjak, në lindje me Bashkinë Peqin dhe në perëndim me detin Adriatik. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Rrogozhinë, Kryevidh, Sinaballaj, Lekaj dhe Gosë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra. Bashkia ka për qendër qytetin e Rrogozhinës, i cili zë rreth një të tretën e të gjithë popullsisë banuese të bashkisë së re.

Qyteti i Rrogozhinës u krijua përreth agroindustrialisë, si fabrika e vajit dhe sapunit apo ajo e zhveshjes së pambukut, si dhe një linjë për përpunimin dhe konservimin e ushqimeve. Kjo industri është mbyllur prej kohësh; ekonomia e bashkisë tashmë fokusohet në dy shtylla kryesore: në bujqësi me rreth 70% territorit të përfshirë në veprimtari bujqësore, si dhe fushën e turizmit, me rreth 20 km vijë bregdetare. Hartimi i planeve të duhura zhvillimore, të shoqëruara me investimet e përshtatshme për rrugë, kanalizime, ndriçim dhe ujë të pijshëm ofron një mundësi për nxitjen e zhvillimit ekonomik në bashki.

Sipas censusit, bashkia e Rrogozhinës ka 22,148 banorë, ndërsa sipas regjistrimit të gjendjes civile, ajo numëron një popullsi prej 40,684 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 223.5 km<sup>2</sup>. Sipas regjistrimit civil, densiteti i popullsisë është 182 banorë/km<sup>2</sup>, ndërsa sipas censusit, densiteti është 99 banorë/km<sup>2</sup>.

### HISTORIKU

Qyteti i Rrogozhinës i njohur në literaturën arkeologjike dhe historike me emrin "Asparagium", përmendet si një vendbanim i lashtë dhe udhëkryq i rëndësishëm gjeografik dhe historik. Asparagium ndodhej në kryqëzimin e dy segmenteve të rrugës

“Egnatia”, të cilat vinin nga Apollonia dhe Dyrrakium në drejtim të Romës dhe Kostandinopojës. Rrogozhina, përveçse nyje e rëndësishme tregtare dhe gjeografike, mbart mbi vete kultura, tradita, zakone dhe veçori gjuhësore midis Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Jugut.

Rrogozhina e sotme, e pozicionuar midis Durrësit, Lushnjës dhe Elbasanit, është nyje e rëndësishme e korridorit të 8-të, dhe e kryqëzimit hekurudhor Rrogozhinë–Durrës, Rrogozhinë–Vlorë dhe Rrogozhinë–Pogradec. Midis viteve 1960-1990, qyteti i Rrogozhinës kishte disa prej fabrikave më të rëndësishme të prodhimit, si ajo e vaj-sapunit ku prodhohej vaji i lulediellit dhe ku kishte linjë të përpunim-konservimit të ushqimeve, midis së cilave edhe një fabrikë makaronash. Uzina e zhveshjes së pambukut, ku vinte pothuaj i gjithë prodhimi vendas i pambukut, si edhe punishtja e përpunimit të bimëve mjekësore dhe etero-vajore e renditën qytetin përsëri krahas qyteteve të tjera të rëndësishme të industrisë së lehtë dhe prodhimit ekonomik.

## KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE TË BASHKISË RROGOZHINË

Bashkia Rrogozhinë shtrihet në Shqipërinë e mesme, duke u ndërlidhur me akset rrugore kryesore në rajon, e cila pozicionon bashkinë si nyje ndërlidhëse e flukseve ekonomike. Klima mesdhetare dhe karakteristikat gjeologjike ofrojnë mundësi zhvillimi të mëtejshme të bujqësisë dhe blegtorisë. Afërsia me detin Adriatik, peizazhi bujqësor dhe tradita përbëjnë potencial të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të turizmit. Në territorin e bashkisë Rrogozhinë regjistrohen rreth 559 biznese të cilat janë të specializuara në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, ku më shumë se 90% e tyre konsiderohen si biznese të vogla<sup>6</sup>.

Sektori i shërbimeve është një sektor tejet i rëndësishëm, i cili përqëndrohet kryesisht në Njësinë Administrative Rrogozhinë dhe përgjatë vijës bregdetare. Ky sektor orientohet kryesisht drejt turizmit, i cili përbën një potencial të lartë zhvillimi për shkak të pasurive natyrore, kulturore dhe klimatike.

Megjithëse vitete e fundit vërehet një zhvillim i sektorit turistik, vlen të theksohet se ende ka mungesë në lidhje me cilësinë dhe larmishmërinë e shërbimeve, vështirësi në përthithjen e turizmit afatgjatë dhe mungesë e orientimit të ofertës drejt kërkesës së tregut. Për këtë arsye është e nevojshme zhvillimi i mëtejshëm i strukturave akomoduese dhe shërbimeve, si dhe promovimi dhe ndërlidhja me agroturizmin dhe turizmin kulturor, duke synuar një turizëm afatgjatë, cilësor dhe atraktiv.

<sup>6</sup> Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Rrogozhinë.

## KARAKTERISTIKAT SOCIALE TË BASHKISË RROGOZHINË

Raporti i Vlerësimit të Nevojave për Shërbime Sociale<sup>7</sup> dëshmon se 242 familje përfitojnë ndihmë ekonomike në Bashkinë Rrogozhinë. Numri më i lartë i aplikuesve për ndihmë ekonomike (NE) në të dy vitet e analizuara është në njësitë administrative Rrogozhinë dhe Gosë. Njësitë Gosë dhe Sinaballaj karakterizohen për pjesën më të lartë të familjeve përfituese në raport me popullsinë, rreth dy deri tre herë më të lartë se sa pesha në përqindje e përfituesve të NE në njësitë e tjera. Ky përfundim vlen për vitin 2018 dhe 2019. Analiza tregoi se familjet përfituese të NE janë thuajse tërësisht rurale, ndonëse i gjithë territori i bashkisë konsiderohet vendbanim rural. Fëmijët zënë një peshë të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të anëtarëve të familjeve përfituese të NE, gjë e cila duhet të konsiderohet në hartimin e politikave lokale të mbështetjes nëpërmjet NE ose formave të tjera të shërbimeve sociale.

Familjet përfituese të NE kanë në përbërje të tyre individë me aftësi të kufizuara, gjë që vështirëson situatën sociale dhe ekonomike të familjes, sidomos në raport me tregun e punës, duke zvogëluar mundësitë e punësimit, përfshirjes dhe integritit të familjes. Gjithashtu, familjet përfituese ku mbajtësi është grua zënë peshë të konsiderueshme.

Megjithatë, fakti që numri i individëve të varfër, i përkufizuar në përputhje me standardin kombëtar të varfërisë, është më i vogël se sa numri i përfituesve të NE, duhet të shërbejë si një drejtim për analiza më të thelluara, të cilat jo vetëm do të ndikonin në rritjen e efektivitetit të ndihmës ekonomike, por edhe do të ri-dimensiononin fondet përkatëse, në përputhje me drejtimet më prioritare.

### *Punëkërkuessit*

Janë gjithsej 528 punëkërkuess të papunë në Bashkinë Rrogozhinë. Papunësia ka profil krejtësisht rural edhe për arsye se banorët që posedojnë tokë nuk mund të konsiderohen të papunë. Gjithashtu konstatohet se papunësia është edhe faktori kryesor që i shtyn familjet drejt ndihmës ekonomike sepse siç konfirmohet nga të dhënat punëkërkuessit e papunë janë të gjithë përfitues të ndihmës ekonomike.

---

<sup>7</sup> Plani Social i Bashkisë Rrogozhinë 2020-2022.

## TURIZMI

Zhvillimi i turizmit është kthyer në prioritet edhe për Bashkinë e Rrogozhinës si rezultat i reformës së re administrative-territoriale sipas së cilës, 15.52 km vijë bregdetare i kalohen nën juridiksion Bashkisë. Kjo vijë bregdetare shtrihet përgjatë plazhit të Spillesë dhe bën pjesë në njësitë administrative Gosë e Kryevidh. Duke filluar prej sezonit veror të vitit 2016, një pjesë krejtësisht e pa shfrytëzuar e plazhit, është kthyer tashmë në atraksion pushimi dhe turizmi veror për pushues kryeqytetas dhe të zonës përreth. Ndryshe nga shumë zona turistike bregdetare të vendit, në të cilat situata është tepër kaotike si rezultat i ndërtimeve informale përgjatë vijës bregdetare, në këtë zonë panorama është krejt e kundërt dhe tejet e favorshme për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit bregdetar sezonal.

Në hapësirat publike të shtrira përgjatë vijës bregdetare janë ndërtuar 34 stacione plazhi ku çdo njeri prej tyre ka një hapësirë nga 200 deri në 5000 m<sup>2</sup> në përdorim. Midis stacioneve të plazhit, sikurse parashikohet në VKM nr. 369 datë 18.05.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, është ruajtur një hapësirë e pashfrytëzuar prej 30 m, janë vendosur 8 kulla vrojtimi me 16 roje plazhi, të cilët patrollojnë gjatë gjithë sezonit veror në shëtitoren e plazhit. Përgjatë vitit 2016 janë numëruar 20 mijë pushues në ditë<sup>8</sup> dhe numri i biznesve është rritur ndjeshëm duke kontribuar kështu në rritjen ekonomike të gjithë zonës.

Atraksionet ditore për pushuesit si shumëllojshmëria kulinare, aktivitetet sportive, bar-et etj., pasurohen me aktivitete të tjera përgjatë sezoneve në vijim si festivalet verore, kampingje për makinat rulot, peshkim, panairë, etj.

### *Kalaja e Bashtovës*

Zona e Bashtovës, e cila përmendet në dorëshkrimet historike si port lumor në Shkumbin dhe qendër e eksportit të drithërave, është sot një nga zonat me potenciale zhvillimi turistike më të mëdha në zonë. Në këtë zonë ndodhen dy monumente kulturore shtetërore: Kalaja e Bashtovës, monument kulture, dhe pylli i dafinave, monument natyre, i cili lulëzon përqark kalasë.

Kalaja e Bashtovës, monument kulture i qytetërimit mesjetar, ngrihet pranë fshatit Vilë-Bashtovë, në një distancë rreth 3-4 km në veri të grykëderdhjes së lumit Shkumbin.

---

<sup>8</sup> Të dhëna nga Bashkia Rrogozhinë.

Kalaja është ndërtuar në shekullin e XV dhe u ka shërbyer venecianëve për shkëmbime tregtare. Ajo ka formë katërkëndore me përmasa 60 x 90 m, dhe mure 9 m të lartë. Kullat janë rrethore ose drejtkëndëshe në planimetri, të mbuluara me çati druri dhe të pajisura me vrima në nivelin e tokës. Në fillim muret ishin 9 m të larta, por sot duken shumë më të ulëta për shkak të aluvioneve të përmbytjeve të lumit Shkumbin. Gjerësia e mureve varion nga 1 m në më pak se 0,5 m.

Pjesa perëndimore e Kalasë është rindërtuar në shekullin e XVIII. Sipas të dhënave historike dhe arkeologjike kalaja mendohet të ketë qenë dy-katëshe, por një kat i saj është tani nën sipërfaqen e tokës, rrënojat e të cilit mbeten ende për t'u zbuluar. Kalaja e Bashtovës njihet si e vetmja kala në Ballkan e ndërtuar në fushë. Rrethinat e saj kanë mbetur të plota dhe ende vizitohen nga shumë turistë. Shumë objekte të zbuluara në kala ruhen sot në Muzeun Kombëtar në Tiranë. Ndër të tjera, zona e Bashtovës, njihet edhe për shumëllojshmërinë e prodhimit të djathrave dhe prodhimin e vajit të ullirit. Në të ndodhet gjithashtu një prej fermave më në zë të vendit për prodhimin e kërmijve.

### *Rrënoja arkeologjike në qytet*

Ndër gjetjet më të rëndësishme arkeologjike të zbuluara në vitet e fundit në Rrogozhinë janë varret monumentale të datuara në shekujt IV–V të erës sonë, rrënojat e një godine, e gërmuar pjesërisht, në afërsi të varreve, si dhe materiali qeramik i gjetur në anën lindore të saj, të datuara nga periudha romake dhe antikiteti i vonë. Kërkimet gjeofizike të realizuara nga specialistët e Qendrës Gjeofizike Tiranë dhe gjeofizikantët e Universitetit të Selanikut<sup>9</sup> duke u fokusuar në pjesën veriperëndimore të Rrogozhinës. Kërkimet evidentuan gjetje rrënojash në rastet e hapjes së themeleve për ndërtimin e shtëpive të reja, siç ishte zona pas shkollës së mesme të qytetit në një sipërfaqe që shtrihej deri mbi hekurudhë në gjerësi, dhe në linjën gjatësore shtriheshin nga stacioni hekurudhorë deri te “Dy çezmat”, në dalje të qytetit në anën veriore.

Rrënojat ndërpriten në në linjën e drejtë nga ana perëndimore. Në dalje të qytetit nga ana e Peqinit, kohë më parë ekzistonte një urë guri, pjesë e rrugës së vjetër por aktualisht nuk ka mbetur ndonjë fragment konstruksioni mbi sipërfaqe për të parë teknikën e punimit. Kodra mbi të quhet “Kodra e Saragut”, toponim që të kujton emrin Asparagum të përmendur në rrjedhjen e poshtme të luginës së Shkumbinit gjatë

---

<sup>9</sup> Kërkimet gjeofizike në Rrogozhinë u kryen në kuadrin e Projektit bilateral Shqipëri – Greqi 2003-2004 me temë: Kërkimet emergjente arkeologjike në “Via Egnatia” duke përdorur metodat e reja gjeofizike (tomografi) në kuadër të ndërtimit të Koridorit të 8-të. Në këtë projekt bashkëpunuan: Qendra Gjeofizike (Prof. S. Bushati, Ll. Prenga, S. Nenaj, Dr. H. Reçi); Fak. Gjeofizikës së Universitetit të Selanikut (Dr. G. Sideris, Dr. F. Zervos) dhe Instituti i Arkeologjisë Tiranë (I. Gjipali e L. Bejko).

luftërave të Cezarit me Pompeun<sup>10</sup>. Gjurmët e konstatuara si në territorin e qytetit dhe në lagjen veriperëndimore të tij, krijojnë një kompleks më të madh, që mund t'i përkasë një vendbanimi dhe stacioni rrugor të Egnatias në periudhën e vonë romake.

Strukturat e rrënojave të kompleksit, të evidentuara nga kërkimet gjeofizike, për nga pozicioni do t'i shkonin fare mirë një stacioni rrugor të veçuar nga qendra e banuar aty pranë. Të dhënat e deritanishme nuk mjaftojnë për ta pohuar një gjë të tillë. E mundshme është gjithashtu që stacioni rrugor të gjendet edhe pranë qendrës së qytetit të sotëm ku kanë dalë rrënoja. Referuar të dhënave nga kërkimi, përse i përket lidhjes së mundshme të dy degëve të Egnatias në Rrogozhinë këtu nuk mbështetet nga të dhënat arkeologjike. E vetmja urë pas asaj të Topçiasit, është ajo pranë Bashtovës, disa kilometra larg derdhjes së Shkumbinit në det.

### *Fosilet detare të Thartorit*

Fosilet detare të Thartorit janë molusqe detare. Ato bëjnë pjesë në Monumentet e Natyrës të qarkut të Tiranës, ku bën pjesë edhe Rrogozhina. Fosilet detare të Thartorit gjenden me shumicë në faqen e zhveshur dhe shumë të pjerrët të kodrës lindore të fshatit me të njëjtin emër. Këto fosile përbëhen nga guacka molusqesh detare të quajtura "Ostrea". Ato kanë ekzistuar aty që në epokën gjeologjike, miliona vjet më parë. Shkencëtarët mendojnë se ato kanë mbetur aty, kur toka për shkaqe tërmetore, apo arsye të tjera, u ngrit dhe deti u tërhoq më në perëndim. Disa shkencëtarë të tjerë mendojnë që molusqet detare të Thartorit i lidhin me "Përmbytjen e Madhe", që ka ndodhur rreth 15.000 vjet më parë.



Fig. Fosilet detare të Thartorit, Rrogozhinë

<sup>10</sup> Caesar, Ilirët dhe Iliria, Mbi luftën civile, 76, f. 92.



Sidoqoftë, ato kanë vlera të veçanta paleontologjike, sepse ndihmojnë që të hidhet dritë mbi evolucionin e strukturës gjeologjike të mjedisit të të gjithë zonës. Njëherazi, ato kanë edhe vlera kulturore të karakterit vendor. Guaskat e Thartorit janë me vija të theksuara, ku vija 1 dhe 2 janë më të trasha; disa të tjera janë të bardha, pa shirita. Gjithashtu, aty gjenden edhe guaska të tjera që kanë po të njëjtin dekor si guaskat e mësipërme, por ky dekor në vijën 2 dhe 3 janë pothuaj të puqura dhe dy të tjera të holla të zbehta. Fosilet detare të Thartorit janë me interes për studiuesit, por edhe për vizitorët që mund t'i shohin ato.

### *Burimet sulfurore të Fliballies*

Burimet sulfurore të Fliballies janë ujëra termale me përmbajtje të lartë sulfuri. Ato burojnë rrëzë Shkëmbit të Madh në Rostej, buzë përroit të Rrushtës, përballë shkëmbit të fshatit Kazie, Peqin. Sot këto burime kanë prurje të pakëta, por dikur duhet të kenë patur më shumë prurje, madje, të dhënat gojore thonë se ato kanë qenë funksionale deri vonë. Duke qenë ujëra termale, me përmbajtje sulfuri, ato mbajnë erën e tyre karakteristike.

Temperatura e ujërave të këtyre burimeve është pak më e lartë se e mjedisit përreth. Nga vëzhgimi që i është bërë zonës përreth nuk rezultojnë burime të tjera, por ato shfaqen në anën verilindore të Fliballies, më shumë në Fushën e Duzhjes, ndërmjet Mlikut dhe Ballashenit. Banorë të zonës shprehen se burimet sulfurore të Fliballies janë përdorur deri vonë si ujëra termale, "llixha" ditore, ku vinin të sëmurë, bënin gropat që mbusheshin me ujë dhe futeshin brenda. Rëndësia e këtyre ujërave është kombëtare, shkencore, kulturore e turistike.

## **PROFILI I ARTIZANËVE KAVAJË DHE RROGOZHINË**

Nga puna e realizuar në terren për hartëzimin e artizanëve, janë identifikuar 21 artizanë, nga të cilët 20 në Kavajë dhe 1 në Rrogozhinë. Pjesa më e madhe e tyre (71%) janë gra, të cilat merren kryesisht me qëndistari dhe me punimin e qilimave në tezgjah. Në Kavajë vërehet se burrat janë të angazhuar në poçari dhe në punimin e bakrit dhe teneqes; kurse në Rrogozhinë nuk u identifikuan artizanë burra.

Për të mundësuar paraqitjen e situatës së artizanëve në zonën e projektit, u zhvilluan intervista të strukturuar me disa nga artizanët e identifikuar gjatë fazës së hartëzimit, të cilët e ushtrojnë profesionin në mënyrë të vazhdueshme dhe i konsiderojnë fitimet

nga prodhimi dhe shitja e produkteve artizanale si një nga burimet kryesore të të ardhurave për familjen e tyre.




Fig. Grafikët e të dhënave demografike të artizanëve të identifikuar




Fig. Grafikët e të dhënave mbi veprimtarinë e artizanëve të identifikuar

## NEVOJAT DHE PROBLEMATIKAT

Sipas artizanëve të intervistuar, prodhimet artizanale shihen si mundësi alternative punësimi, të cilat në një farë mënyre kanë ndikuar në zbutjen e varfërisë dhe nxitjen e biznesit të vogël në Kavajë; ndërkohë, në Rrogozhinë është identifikuar një artizane e cila qëndis, por punimet e së cilës nuk arrijnë të futen në tregun e shitjeve.

*Kërkesa për produkte artizanale* - Artizanët shprehen se prodhimet artizanale që gjejnë përdorim në jetën e përditshme janë ato më të kërkuara nga klientët. Për disa veprimtari, si puna në grep dhe qëndisjet, vërehet në veçanti një rritje e kërkesës nga viti në vit. Disa artizanë shprehen se janë ndeshur me klientë që kërkojnë produkte me

elemente të traditës por të sjella në kohë, dhe për artikuj të personalizuar që identifikojnë atë që ata duan, me një ndjeshmëri në rritje për artikujt e ricikluar. Për këto kërkesa, ata shprehen se është e nevojshme të realizohen trajnime specifike.

*Vështirësitë e të qënit artizan* - Artizanët shprehen se shumë prej tyre që merreshin me zejtari kanë emigruar, ndërsa ata që punojnë ende, shpesh e kanë këtë si punë të dytë. Për ta është e mundimshme të punosh në artizanat, në një kohë kur puna e tyre nuk vlerësohet si dikur. Shumë nga punimet artizanale janë imitime dhe shumë pak mbetet krijimtari (kryesisht në rastet kur porositen modele të vjetra të realizuara nga vetë artizani).

Ata shprehen se *tregu është tejmbushur me prodhime të cilësisë së dobët si dhe imitime*, që jo vetëm nuk bëhen në vendin tonë, por edhe shtrembërojnë elementet e traditës, e tregtohen nën ombrellën e punimeve artizanale.

Po ashtu, *mungesa e lëndës së parë dhe pamundësia për ta siguruar atë me larminë e mundshme*, në kohë të shkurtër, vështirëson punën e tyre duke sjell edhe vonesa në realizimin e krijimeve. Artizanët e përfshirë në punë në tezgjah shprehen se janë të varur nga 1 furnitor, dhe shpesh vonesat prej tij bëjnë që të ketë vonesa edhe në realizimin e punimeve dhe përmbushjes së afateve të vendosura me klientët.

86%

Nuk bëjnë marketing për produktet/biznesin e tyre

62%

Nuk kanë trajnuar të tjerë mbi teknikat e profesionit të tyre

100%

Nuk ofrojnë kurse për fëmijët dhe vizitorët e interesuar

76%

Nuk janë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Punët e dorës së grave janë ato që më së shumti i kanë rezistuar kohës, deri në ditët e sotme. Qilimat e prodhuara nga gratë e zonës, janë të një cilësie të lartë dhe tepër të preferuara. Një vend të rëndësishëm në punëdoret e grave e zë edhe puna në grep si dhe qëndisjet. Shumë e lashtë vjen tek gratë tradita e punimit të leshit, të cilin më pas e përdorin për të realizuar qilimat. Sot sfida më e madhe e artizanëve është trashëgimia e punës së tyre brez pas brezi duke përçuar traditën dhe kulturën e vjetër; artizanët njëzëri janë mjaft pesimist dhe me keqardhje shprehen se është e vështirë të angazhojnë të rinjtë, pasi një pjesë e madhe e tyre është larguar nga Kavaja drejt Tiranës apo dhe jashtë vendit.

*Tregu* - Punimet artizanale janë të destinuara për tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Tregu i brendshëm përfshinë Kavajën, Durrësin dhe Tiranën. Shitjet në tregun e brendshëm bëhen kryesisht:

- Nëpërmjet daljes dhe shitjes herë pas here në tregun ditor të Kavajës dhe Durrësit, apo lidhje me dyqane specifike në Tiranë. Por kjo lloj shitje shoqërohet me humbje kohe e kosto transporti.
- Ndërmjet panairëve sporadike të organizuara nga njësitë e qeverisjes vendore apo nga donatorë e organizata të ndryshme (si p.sh. më së fundmi përmendet panairi i realizuar nga organizata ANRD<sup>11</sup>, me mbështetjen e UN Women). Panairët janë mënyrë e mirë promovimi për të zgjeruar tregun.
- Për promovimin e vlerave dhe rëndësisë kulturore e historike të prodhimeve artizanale në Kavajë është ngritur e më së fundmi rehabilituar rruga e artizanëve, por ky “treg” nuk është funksional; në një pjesë të dyqaneve janë vendosur veprimtari tregtare që nuk lidhen me zejtarinë, ndërsa pjesa tjetër është dhënë me qira por ende pa veprimtari në to. Ndër të tjera, duket se artizanët në këto zona nuk janë të njohur nga agjencitë turistike. Mungon lidhja mes prodhuesve artizanal dhe agjencive turistike në mënyrë që prodhimet artizanale të shihen si një destinacion turistik kulturor.
- Në bazë të kërkesave - porosive për zbukurim, arredim dhe pajisje të restoranteve tradicionale që kohët e fundit kanë filluar të zgjerojnë aktivitetin e tyre (rasti i poçarisë).
- Një mënyrë tjetër është sistemi i porosive online, ku anëtarët më të rinjë të familjes angazhohen më tepër përmes promovimit virtual një strategjie marketingu shumë modeste. Megjithatë, kjo formë përdoret më pak; disa prej artizanëve po përpiqen të përdorin Shopify për të tregtuar dhe promovuar produktet e tyre. Artizanët shprehen se nuk nuk i kanë përdorur më herët për shkak të tarifave të larta të postave alternative, që nga ana tjetër mbeten të pasigurta, korrekësia e tyre ndër të tjera konsiderohet një tjetër problem.

Tregu i jashtëm është kryesisht tregu italian dhe grek. Ky treg funksionon mbi bazë të porosive. Është treg me kosto transport, transaksionesh dhe me burokraci doganore, por ka nxitur dhe stimuluar deri diku prodhimin artizanal në këtë zonë. Përmirësimi i kanaleve të tregut është një mundësi për përmirësimin e zinxhirit të vlerës, prandaj është e domosdoshme njohja e drejtpërdrejtë e dinamikës së tregut, shkëmbimi i

---

<sup>11</sup> ANRD, 2022. Artizanati dhe mirëqenia e grave dhe vajzave në qendër të Panairit të Artizanatit.

informacionit për tregun, trajnimet dhe shkëmbimin e përvojës në fushën e tregtimit dhe marketingut.

Në rastin e punimeve në tezgjah dhe qëndisjen, vërehet se mungon lidhja dhe bashkëpunimi me Univerisitetin, siç është departamenti i Tekstiles dhe Modës në Fakultetin e Inxhenierisë Mekanike të Univeritetit Politeknik të Tiranës (UPT). Ky departament në historinë e tij ka përgatitur dhjetra specialistë të tezgjahut, por njëkohësisht është një qendër e rëndësishme kombëtare në fushën kërkimore të teknologjisë tekstile dhe materialeve tekstile, si dhe atë të disanjit dhe modës.

*Informacion i kufizuar dhe njohuri të pakta të artizanëve mbi politikat dhe nismat kombëtare në dobi dhe interes të përfshirjes në sipërmarrje. Para shtatorit të 2012 mbështetja për artizanët ka qenë e kufizuar, ndërkohë sot krijimi i fondit të ekonomisë kreative konsiderohet një mbështetje e mirë për artizanët. Fondi i ekonomisë kreative ka për qëllim dhënie të ndihmës financiare në formë subvencionit të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e artizanëve, ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, në vlerën deri në 500,000 (pesëqind mijë) lekë. Agjencia Shqipëtare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është institucioni përgjegjës për administrimin e këtij fondi. Megjithatë, nga intervistat vërehet se artizanët nuk kanë informacion mbi këtë nisëm.*

## ANALIZA SWOT

Duke qenë se zejtaria në Shqipëri në vitet e fundit është një sektor në rritje dhe me potencial të madh, analiza SWOT është një kuadër i dobishëm për të analizuar pikat e forta dhe të dobëta të sektorit, si dhe mundësitë dhe kërcënimet. Kjo do t'a ndihmonte sektorin që të përqendrohet në pikat e forta, të punojë me pikat e dobëta, të minimizojë kërcënimet dhe të shfrytëzojë mundësitë e disponueshme.

Punimet artizanale të dorës kanë traditë të gjatë dhe mund të pasurojnë përvojën e turizmit, ruajtjen dhe zhvillimin e traditave kulturore, artistike dhe historike, si dhe krijimin e të ardhurave në zonat rurale, nëse integrohen me zhvillimin e turizmit. Është shumë e rëndësishme që të gjithë aktorët e përfshirë në sektorin e zejtarisë të punojnë në drejtim të reduktimit të pikave të dobëta të sektorit dhe minimizimit të efekteve të mundshme negative të kërcënimeve ekzistuese ose të ardhshme.

## ARTIZANATI NË KAVAJË DHE RROGOZHINË

Disa zhvillime mund të ndikojnë negativisht në performancën e sektorit, ku përmenden tendenca në rritje e të rinjve për t'u larguar nga zonat rurale, konkurrenca nga produktet e importuara, etj. Në tabelën më poshtë paraqitet një analizë e hollësishme SWOT, e cila është bazuar në shqyrtime të literaturës dhe konsultime të hollësishme me artizanë të dy zonave të projektit.

<b>Pikat e forta</b>	<b>Dobësitë</b>
Produkte unike tradicionale	Mungesa e marketingut dhe promovimit cilësor
Produkte të cilësisë së lartë	Mungesa e trajnimeve dhe mbështetjeve të tjera
Njohuri dhe aftësi të nivelit të lartë mbi produktet tradicionale	Mungesa e strategjive lokale ndërsektoriale për zhvillimin e zejtarisë
Punimet artizanale pasurojnë përvojën e turizmit, ruajnë e zhvillojnë traditat kulturore, artistike e historike, dhe krijojnë të ardhura në zona rurale	Shpërndarja gjeografike e artizanëve në disa njësi administrative të qeverisjes vendore
	Mungesa e studimit të zinxhirit të vlerës së sektorit
	Pamjaftueshmëria e portaleve online ku mund të promovohet puna e artizanëve
<b>Mundësitë</b>	<b>Kërcënimet</b>
Kërkesa në rritje për produkte unike artizanale në vend dhe në tregun e jashtëm	Konkurrenca nga produktet e importuara dhe jo-origjinale
Zhvillimi i sektorit të turizmit vendas dhe ndërkombëtar	Ndryshimet e shpeshta të taksave dhe tarifave doganore për importin dhe eksportin e lëndëve të para dhe produkteve
Potencial për eksporte me marketing më të mirë	Migrimi dhe plakja e popullsisë vendase
Zhvillimi i industrisë së modës dhe pronave të patundshme rrit kërkesën për produkte artizanale	Humbja e traditës së punës artizanale dhe motivim i ulët nga grupmoshat më të reja
Tregtia online dhe interneti si kanale premtuese për produktet artizanale	
Rrjetëzimi i artizanëve për gjetjen e tregjeve të reja	
Rritja e shitjeve nëpërmjet përmirësimit të marketingut dhe rritjes së informacionit	
Lidhja me aktorë të tjerë për të rritur produktivitetin	

Tabela: Analiza SWOT e sektorit të zejtarisë

## MUZEU ETNOGRAFIK

Muzeu Etnografik i Kavajës ndodhet brenda një shtëpie tradicionale të ndërtuar në vitin 1800, e cila u shndërrua në muze në 1971. Me një fond etnografik prej rreth 810 objekte të tipologjive të ndryshme, muzeu paraqet jo vetëm arkitekturën dhe strukturën e banesave tradicionale të kohës, por edhe stilin e jetesës dhe ekonomitë e Kavajës dhe krahinave përreth, duke u bërë kështu një pikë e rëndësishme interesi jo vetëm për turistët e zonës por edhe për banorët e Kavajës.

Së fundmi, muzeu i është nënshtruar restaurimeve, në përfundim të të cilave pritet që potenciali i muzeut për të qenë një model vetë-financues biznesi të shfrytëzohet. Në kuadër të kësaj nisme rijetëzuese të mbështetur nga projekti 'Bashkimi Evropian për Kulturën' (EU4Culture) i cili financohet nga BE dhe zbatohet nga UNOPS në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Kulturës, është parashkuar edhe krijimi i një punishteje për prodhimin e produkteve me bazë qeramike dhe argjileje në muze për qëllime demonstrimi, duke qenë se prodhimi i këtyre produkteve është pjesë e traditës shumëvjeçare të zonës. Produktet e krijuara do të shiten në muze, duke i krijuar kështu muzeut mundësi vetë-financimi të qëndrueshme.

## MEDIAT SOCIALE

Platformat e mediave sociale prej kohësh luajnë një rol të qenësishëm jo vetëm në jetët tona, por edhe në ekonomi, përfshirë industrinë e kulturës dhe turizmit. Mediat online si Facebook, Instagram etj., kontribuojnë në promovimin dhe marketimin e produkteve dhe shërbimeve turistike të operatorëve të ndryshëm, por edhe u mundësojnë turistëve dhe vizitorëve të njihen vetë me një mori destinacionesh, vendesh dhe pikash interesi.

Në vitet të fundit, marketingu dhe strategjitë e shitjes kanë evoluar. Marketingu i kryer nëpërmjet mediave sociale është një nga format më të njohura dhe më të suksesshme të marketingut digjital. Falë numrit të madh të përdoruesve aktivë të rrjeteve sociale, reklamat e bizneseve mund të shikohen nga miliarda klientë të mundshëm të targetuar sipas faktorëve demografikë dhe socio-ekonomikë që përcakton vetë marketuesi, duke i dhënë promovim dhe ekspozim të paprecedent markave dhe produkteve ose shërbimeve të tyre.

'Shitja sociale' është një strategji shitjesh që përdor platformat e mediave sociale si Facebook, Instagram, LinkedIn, etj, për të krijuar marrëdhënie me klientët e mundshëm të synuar si dhe për të rritur informimin dhe ndërgjegjësimin mbi identitetin e markës.

Është një mënyrë gjithmonë e më popullore për t'u lidhur me klientët e synuar, duke qenë se mënyra si bëjmë shitje po evoluon shpejt, dhe tanimë fokusi është në ndërtimin e besimit dhe marrëdhënieve të forta me klientët. Përdorimi i mediave sociale për shitje mundëson komunikim të shpeshtë me klientë dhe forcimin e marrëdhënieve profesionale. Duke u mundësuar klientëve të njihen me markën dhe të fitojnë besim në atë që marka ofron, bizneset krijojnë bazën për angazhim të qenësishëm dhe të vazhdueshëm mes klientëve.

Dy mediat sociale më të preferuara për promovimin e shitjeve, sipas një sondazhi botëror, janë Facebook dhe Instagram. Nga janari 2022, platforma sociale më e përdorur nga tregtarëve në mbarë botën ishte Facebook. 90 për qind e tregtarëve në media sociale preferojnë platformën Facebook për të promovuar bizneset e tyre, kurse 79 për qind përdorin Instagramin.<sup>12</sup>

## TREGU ONLINE

Tregjet online janë kompani të teknologjisë së informacionit që kryejnë funksion ndërmjetës duke ndërlidhur blerësit me shitësit. Këta të fundit ekspozojnë produktet e tyre, me çmimet dhe informacion përkatës në faqen e internetit të tregut online. Nga ana tjetër, klientët kërkojnë dhe shikojnë produktet, dhe në fund blejnë drejtpërdrejt nga shitësit. Tregjet online preferohen nga shitësit sepse kanë më pak shpenzime se dyqanet fizike. Ndërsa konsumatorët preferojnë blerjet online sepse kursejnë kohë dhe kanë më shumë opsione prej të cilave mund të zgjedhin pa u lodhur. Disa nga platformat më të njohura për tregun online janë Amazon, Alibaba, Etsy, etj.

## ETSY

Etsy është një kompani Amerikane për tregtinë online, që fokusohet te produktet antike ose të bëra me dorë, duke përfshirë veshje, aksesore, mobilje dhe dekor, lodra, vepra arti, etj. Platforma, e themeluar në 2015, funksionon si një panair i hapur, ku shitësit kanë vitrina virtuale të personalizuar për të shfaqur krijimet e tyre ose produktet antike që tregtojnë.

Në vitin 2021, Etsy numëronte mbi 120 milion produkte të ekspozuara në tregun online, dhe gjeneroi një total prej 13.5 miliard dollarësh nga shitjet. Platforma ndihmoi në ndërlidhjen e 7.5 milion tregtarëve me 96.3 milion blerës<sup>13</sup>.

<sup>12</sup> Statista Research Department. 2023.

<sup>13</sup> United States Securities and Exchange Commission. 2022.



## ALBARTIZAN

Albartizan është një platformë e-commerce që mbledh artizanët shqiptarë në një hapësirë të dedikuar për të promovuar punën artizanale dhe zhvillimin e ekonomisë vendase. Lindur nga nevoja për të promovuar punën artizanale, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik lokal, sidomos të grave, ky portal krijon mundësi për rrjetëzimin e artizanëve, duke inkurajuar nismat e bashkëpunimit mes tyre. Në vitrinat e tyre virtuale, artizanët shqiptarë anembanë botës mund të paraqesin krijimet e tyre. Këto hapësira të dedikuara i mundësojnë klientëve të shfletojnë produkte të veçanta artizanale, të njihen me artizanët dhe punët e tyre, si dhe të vetëdijësohen mbi traditat kombëtare të krijimeve artistike artizanale.

## TURIZMI KREATIV

Turizmi kulturor, d.m.th., “udhëtimi i njerëzve drejt destinacioneve specifike që ofrojnë atraksione kulturore me qëllim përvetësimin e njohurive dhe përvojave të reja që plotësojnë nevojat intelektuale dhe rritjen individuale të udhëtarëve”<sup>14</sup>, është kthyer në një treg të rëndësishëm brenda industrisë së turizmit, duke frymëzuar zhvillimin e vendeve të panjohura kulturore në pika atraktive turistike, dhe duke nxitur kështu rritjen ekonomike në vendet e destinacionit.

Por, brenda këtij sektori të industrisë së turizmit, vitet e fundit, është krijuar një nën-sektor i veçantë për turizmin kreativ. Turizmi kreativ u përkufizua së pari në vitin 2000 nga Richards dhe Raymond si “turizëm që u ofron vizitorëve mundësinë për të zhvilluar potencialin e tyre krijues përmes pjesëmarrjes aktive në kurse dhe përvoja mësimore që janë karakteristike të destinacionit të pushimeve ku ato ndërmerren”. Ndërsa në 2006, Rrjeti i Qyteteve Kreative i Organizatës Edukative, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara (UNESCO) e përkufitoi turizmin kreativ si “udhëtim i drejtuar drejt një eksperience të angazhuar dhe autentike, me të mësuarit me pjesëmarrje në artet, trashëgiminë ose karakterin e veçantë të një vendi, që mundëson një lidhje me ata që banojnë në këtë vend dhe e krijojnë këtë kulturë të gjallë.”<sup>15</sup>

---

<sup>14</sup> Bonetti, E., Simoni, M., & Cercola, R. (2014). Creative tourism and cultural heritage: a new perspective. In Handbook of Research on Management of Cultural Products: E-Relationship Marketing and Accessibility Perspectives (pp. 367-395).

<sup>15</sup> UNESCO Creative Cities Network. 2006. Towards Sustainable Strategies for Creative Tourism: Discussion Report of the Planning Meeting for 2008 International Conference on Creative Tourism.

Elementi kryesor i të dyja këtyre përkufizimeve është pikërisht përfshirja e turistëve apo vizitorëve në një aktivitet krijimtarie që lidhet me kulturën dhe trashëgiminë e destinacionit ku kanë udhëtuar. Eksperienca turistike në këtë kontekst kthehet në një shkëmbim të njohurive, aftësive dhe praktikave kulturore mes vizitorëve dhe prezantuesit pritës, duke krijuar kështu një mënyrë më autentike, unike dhe përfshirëse të të bërit turizëm kulturor. Sektorët që turizmi kreativ ka risjellë në kontekst eksperiencial apo përvoje, duke shfrytëzuar traditat vendase dhe aftësitë praktike të trashëguara të vendasve, përfshijnë artet dhe zejet, dizajnin, sportet, praktikat shëndetësore dhe holistike, gjuhët, traditat gastronomike, etj.

Zhvillimi i kësaj forme të turizmit vjen si rezultat i rritjes së kërkesës për turizëm kulturor, angazhues e përfshirës, përpjekjeve të shtuara të destinacioneve për të ofruar paketa më të veçanta dhe atraktive turistike, si edhe zhvillimit të përgjithshëm të 'ekonomisë së eksperiencave'.

## PRAKTIKA TË MIRA NDËRKOMBËTARE

Si rrjedhojë e zhvillimit të madh të sektorit të turizmit kreativ, disa nga platformat më të mëdha që operojnë në industrinë e turizmit, si Airbnb, Tripadvisor, etj., kanë nisur të ofrojnë një mori eksperiencash kreative në destinacione të ndryshme.

### AIRBNB EXPERIENCES

Themeluar në vitin 2008 në Kaliforni, Airbnb është një platformë web që ndihmon turistët të gjejnë lehtësisht akomodim në destinacionet e pushimeve të tyre, duke i lidhur jo vetëm me hotele, por edhe me akomodime informale, si dhoma, apartamente apo bujtina të banorëve vendas. Airbnb nuk zotëron asnjë nga pronat që u ofron përdoruesve, por ndërmjetëson mes turistëve dhe pritësve për kryerjen e rezervimeve.

Së fundmi, Airbnb ka nisur të ofrojë një shërbim të ri, i cili i mundëson turistëve të rezervojnë eksperiencë për të mësuar mbi vendin e destinacionit nëpërmjet përjetimit të kulturës dhe traditave vendase. Eksperiencat e platformës Airbnb janë aktivitete që ideohen dhe organizohen nga vendasit, dhe ndryshe nga guidat turistike konvencionale, eksperiencat e Airbnb-së u ofrojnë turistëve njohuri dhe kujtime të veçanta përmes një qasjeje më të brendshme, pjesëmarrëse dhe përfshirëse të vendet, komunitetet, traditat dhe praktikat kulturore të destinacionit.

Nëpërmjet platformës online apo aplikacionit mobile, përdoruesit e Airbnb-së mund të zbulojnë mbi 50,000 eksperiencë të marketuara<sup>16</sup> duke i filtruar sipas kategorive të ndryshme të eksperiencave (praktikisht 1. art dhe kulturë, 2. ushqim dhe pije, 3. sporte, 4. natyrë, 5. vizita turistike, 6. aktivitete transporti, 7. mirëqënie, dhe 8. argëtim), çmimit, vendit, kohës dhe gjuhës në të cilën do të mbahet aktiviteti. Pasi identifikojnë eksperiencën, përdoruesit mund të lexojnë më shumë mbi aktivitetin, mbi organizuesit e aktivitetit, si edhe komentet e vizitorëve të mëparshëm.

Eksperiencat e marketuara në platformën Airbnb karakterizohen nga 4 elementë:

1. Qasje: Pritësit ndajnë informacion të veçantë mbi destinacionin, kulturën apo komunitetin, që turistët zakonisht kanë vështirësi t'a gjejnë vetë.
2. Perspektiva: Eksperienca kreative i ofron turistëve një dritare në botën e pritësve, pasi këta të fundit, duke ofruar eksperiencat, prezantojnë edhe pikëpamjet e tyre.
3. Pjesëmarrja: Pritësit i japin mundësinë turistëve të angazhohen apo bëhen pjesë e eksperiencës, dhe jo vetëm t'a ndjekin atë pasivisht.
4. Pasioni: Pritësit kanë njohuri të qenësishme apo aftësi të mirëfillta, dhe janë të apasionuar për temën e eksperiencës që i ofrojnë turistëve.

### **VIATOR (TRIPADVISOR)**

Tripadvisor është një kompani udhëtimesh online që operon një faqe interneti dhe aplikacion mobile me të dhëna të gjeneruara nga vetë përdoruesit e platformës. Që prej themelimit në vitin 2000, Tripadvisor ndihmon udhëtarët të gjejnë akomodim, të bëjnë rezervime, të zbulojnë pika interesante atraktive dhe të prenotojnë eksperiencë në destinacionet e pushimeve, si edhe të lexojnë opinionet e udhëtarëve të tjerë që përdorin platformën mbi sa më sipër.

Platforma Viator e Tripadvisor është tregu më i madh online në botë për turet, aktivitetet dhe atraksionet. Ajo i mundëson turistëve anembanë botës të rezervojnë lehtësisht eksperiencë kreative të ndryshme. Turistët mund të identifikojnë dhe prenotojnë eksperiencat nëpërmjet platformës web dhe aplikacionit të Tripadvisor, Viator.com dhe partnerëve të tjerë.

---

<sup>16</sup> Zaidi, T. 2021, Airbnb Experiences Explained. TRVLGuide.

## PRAKTIKA NË SHQIPËRI

### KLO & POTTERY

Klo & Pottery është një sipërmarrje e re e ngritur në qytetin e Tiranës nga dy motra që janë marrë prej vitesh me punime artizanale, specifikisht poçari dhe punë me letër. Klodiana dhe Eda Kondo, janë kthyer prej pak vitesh në Shqipëri, pas shumë vitesh emigrim në Europë dhe Kanada, ku praktikonin poçari në kohën e lirë. Pas kthimit në Shqipëri, vendosën të hapin studion e tyre të poçarisë, ku mund të vazhdonin praktikën e tyre, si edhe t'a ndanin me të tjerë. Shumë shpejt, Klo & Pottery u kthye në një hapësirë shumë të frekuentuar nga shqiptarë dhe të huaj, të cilët ndjekin kurse të përjavshme ose klasa me provë. Pjesëmarrësit në këto klasa mësojnë dhe praktikojnë forma të ndryshme të krijimtarisë me baltë, si puna në çark dhe puna me dorë, si edhe hapat e tjerë të procesit të krijimit, si lyerja dhe dekorimi i punimeve të pjekura në furrë. Së fundmi, motrat kanë nisur të bëhen pjesë edhe e aktiviteteve të mëdha, si festivale apo panaire, ku vizitorët e të gjitha moshave regjistrohen për të marrë pjesë në eksperiencën e poçarisë. Ata mësojnë mbi praktikën e shumta të të punuarit të baltës, dhe praktikojnë një ose dy prej tyre.

### VIKTOR NURÇE

Viktor Nurçe është një artizan dru-gdhendës, që e ka ushtruar profesionin për mbi 30 vite në Shqipëri dhe Greqi. Prej 10 vitesh, ai gdhend në punishten e tij në Qafën e Pazarit në Gjirokastrë.

Së fundmi, ai ka ndërmarrë një nismë të re në punishten e tij, duke i dhënë mundësinë turistëve dhe vizitorëve në Gjirokastrë të shikojnë dhe të përfshihen në procesin e tij të krijimtarisë nëpërmjet workshopeve të gdhendjes. Duke qenë se interesi për turizmin kreativ është në rritje dhe turistët vazhdimisht shprehin kuriozitet për metodat tradicionale artizanale të gdhendjes së drurit, artizani, në bashkëpunim me një agjenci turistike vendase, nisi të ofrojë eksperiencë turistike kreative të gdhendjes. Turistët që dikur ndaleshin vetëm për të vëzhguar mjeshtrin në punë, tani ndalen për t'u bërë pjesë e workshopeve. Gjatë këtyre eksperiencave, vizitorëve si fillim u shpjegohet arkitektura dhe arredimi i shtëpive të vjetra gjirokastrite, në mënyrë që ata të njihen me elemente të veçanta të trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës. Më pas, ata mësojnë të gdhendin drurin, duke pasur mundësinë të krijojnë vetë suvenire me motive nga tavanet e shtëpive gjirokastrite.

## REKOMANDIME

Për të mbrojtur dhe forcuar më tej trashigiminë kulturore dhe zejtarinë në bashkitë Kavajë dhe Rrogozhinë, rekomandohet që bashkitë të përfshijnë në buxhetet e tyre afatmesme aktivitete të cilat promovojnë artizanatin si instrument i fuqizimit ekonomik vendor, rëndësinë e këtij sektori për turizmin, trashëgiminë kulturore dhe identitetin kombëtar si mirëqenien sociale dhe ekonomike të grave dhe vajzave në këto bashki. Më specifikisht, rekomandimet janë por nuk kufizohen nga sa më poshtë:

- **Zhvillimi i një rrjeti të artizanëve**, i cili mund t'i japë mundësi artizanëve të paraqisin punimet e tyre, por edhe të mundësoi shkëmbim përvojash në këtë fushë, apo pjesëmarrje në festivale dhe evente lokale dhe kombëtare të cilat promovojnë punën e artizanëve.
- Ndërmarrja e **fushatave ndërgjegjësuese** në secilën nga bashkitë mbi rëndësinë e trashigimisë kulturore dhe përfitimet nga përfshirja në punën artizanale.
- **Rijetësimi i "Rrugës së artizanëve" në Kavajë**, një rrugë rehabilituar për t'i dhënë mundësi artizanëve të promovojnë dhe shesin punimet e tyre, e cila sot nuk shfrytëzohet për këtë qëllim.
- **Heqja apo reduktimi i taksave dhe tarifave** lokale për bizneset artizanale, nismë e cila mund të ndihmojë aktivitetin ekonomik të tyre.
- **Bashkëpunimi me operatorët turistikë** për zgjerimin e itinerareve lokale duke përfshirë në to edhe qendrat e artizanatit apo punishet artizanale ekzistuese në dy bashkitë, në mënyrë që prodhimet artizanale të shihen si një destinacion turistik kulturor.
- **Promovimi i turizmit kreativ**, një eksperiencë interesante për turistët vendas dhe të huaj, që të angazhohen vetë në një punishte dhe të kalojnë një përvojë të paharrueshme, duke e provuar dhe vetë punën artizanale.
- Realizimi i **workshopeve demonstruese të punës me dorë** duke ftuar fëmijë, të rinj e të reja, të cilët nën kujdesin e artizaneve mund të realizojnë procese të thjeshta të punës së dorës; fëmijët mund të krijojnë copëza arti dhe mund t'i marim me vete në përfundim të workshop-it.
- **Realizimi i panairëve** që mund shërbejnë për t'i dhënë vlerë punimeve, por në të njëjtën kohë edhe për të krijuar lidhje të tregtareve me personat e interesuar për

këtë lloj tregu, gjithashtu mund të shfaqen video gjatë punimit të tyre në punishte, gjë që bën me tërheqëse për turistin.

- **Ekspozita me fotografi** të vjetra në lidhje me artizanatin dhe Kavajën duke krijuar hapësira tërheqëse për shumë vizitorë.
- **Organizimi i konkurseve** me temë të artizanatit për dizenjtë tradicionale më të bukura, për të promovuar dhe vlerësuar punën e artizanit duke ofruar çmime simbolike.

Nisma të tilla ndihmojnë në rritjen e vetëvlerësimit të artizaneve për punën e tyre, përmirësimit të marketingut, rrjetëzimit dhe fuqizimit të artizaneve. Të tilla aktivitete duhet të jenë të qëndrueshme në kohë dhe të mbështeten nga bashkia në bashkëpunim edhe me aktorë të tjerë me qëllim kthimin e artizanatit në një degë me potencial ekonomik e turistik.

## SHTOJCA A: HARTËZIMI

Nr	Emër, Mbiemër	Lloji i zejtarisë	Njësia Administrative	Kontakt
1	Myrvete Topi	Qëndistare e vjetër Zotëron një punishte ku ushtron veprimtarinë dhe ka punësuar disa gra nga Kavaja. Shpesh punon me kërkesë nga dyqane kryesisht në Itali. I biri e ndihmon me promovimin e produkteve në rrjete sociale, dhe së fundmi, me krijimin e një faqeje në shopify, për të shitur online.	Kavajë	0692283322
2	Ligor Kostrica	Poçari Brez i 5 i mjeshtërisë së poçarisë. E ka trashëguar këtë zanat nga babai dhe po e kalon edhe tek 2 djemtë e tij. Lëndën e parë e gjen pa vështirësi në zonë. Baza e krijimtarisë është nga modelet e trashëguara. Është lidhur me biznese të zonës për të shitur produktet e tij, ndërsa klientët vijnë pranë punishtes ose e kontaktojnë nga telefoni. Ka trajnuar të rinj për të mësuar zanatin.	Kavajë	0682162452
3	Ismete Shaba	Qilimpunuese E ka trashëguar zanatin nga e ëma dhe ia ka mësuar edhe vajzës, e cila jeton në Itali, por e ndihmon me kontaktet për shitjen e produkteve. Ka dëshirë t'ia mësojë zanatin brezit të ri.	Kavajë	(E bija) +3938993923 49 <a href="mailto:noelbelaneni@gmail.com">noelbelaneni@gmail.com</a>

**ARTIZANATI NË KAVAJË DHE RROGOZHINË**

4	Ferid Qarri	Teneqepunues Brez i dytë, e ka mësuar zanatin nga i ati dhe e ka trashëguar te djali i madh, Genci, i cili e ndihmon çdo ditë pasi përfundon punën në faasonerinë e këpucëve.	Kavajë	0692591733  <a href="https://facebook.com/ferid.qarri">facebook.com/ferid.qarri</a>
5	Genc Qarri	Djali i Feridit, teneqepunues Ndihmon të atin në punishten e tij pasdite pasi përfundon punën në fasoneri. I pëlqen zanati dhe dëshiron të mësojë të promovojë punën e të atit.	Kavajë	0692591733  <a href="https://facebook.com/genci.qarri">facebook.com/genci.qarri</a>
6	Luçia Hoxha	Qilimpunuese, 46 vjeç E ka mësuar zanatin nga vjehrra e saj, Gjini. Zakonisht punon darkave vonë, pasi përfundon 2 punë të tjera ku është e punësuar. Ka 3 vajza, të cilat e ndihmojnë me fiksimin e leshit në tezgjah dhe me promovimin e punëve në rrjete sociale.	Kavajë	0685166863  <a href="https://facebook.com/luciehoxha.trimi">facebook.com/luciehoxha.trimi</a>
7	Gjini Hoxha	Qilimpunuese Gjini e ka mësuar zanatin në moshën 16 vjeçare, kur punonte në fabrikën e tezgjahut në Kavajë. Së bashku me bashkëshortin e saj, i cili ndërton tezgjahe, punonin e risillnin modele të veçanta që i kishin mësuar gjatë punës në fabrikë. E ka kaluar zanatin te nusja e djalit dhe mbesat.	Kavajë	0685166863
8	Lulëzime Krasnaj	Qëndistare E ka mësuar zanatin nga e ëma dhe e ka trashëguar te vajza e saj e vogël.	Kavajë	0674063113 <a href="mailto:krasnaj@gmail.com">krasnaj@gmail.com</a> <a href="https://facebook.com/lulzimesh.krasnaj">facebook.com/lulzimesh.krasnaj</a>



**ARTIZANATI NË KAVAJË DHE RROGOZHINË**

9	Suzana Istrefi	Qëndistare, 43 vjeç Punon çanta, çadra, triko, kukulla, etj, si me pakicë dhe me shumicë.	Synej	068298511 <a href="mailto:suzanaistrefi@icloud.com">suzanaistrefi@ icloud.com</a>
10	Flutra Zhava	Qilimpunuese, 55 vjeç	Kavajë	0699295400 0676660338
11	Florida Gjergji	Qëndistare, 41 vjeç	Kavajë	0685516456 <a href="mailto:gjergjiflorida@gmail.com">gjergjiflorida @gmail.com</a>
12	Vera Zenelaj	Qëndistare, 34 vjeç	Kavajë	0683736081 <a href="mailto:leonardozenelaj84@gmail.com">leonardozenel aj84@gmail.c om</a>
13	Esmat Xheria	Qëndistare, 37 vjeç	Kavajë	0694683448 <a href="mailto:esmaxheria@gmail.com">esmaxheria@ gmail.com</a>
14	Landi Habili	Poçar	Kavajë	0692934510
15	Sotir Dobja	Bakërpunues	Kavajë	0674833129
16	Mide Murataj	Qëndistare, 35 vjeç	Kavajë	0688446282
17	Fidaije Mata	Qëndistare	Kavajë	0682238820
18	Dallandyshe Muharremi	Qëndistare, 60 vjeç Ka përfunduar shkollën e mesme profesionale për tekstil dhe ka punuar për mbi 15 vite	Kavajë	0675307658 <a href="mailto:Dallandyshe.muharremi@gmail.com">Dallandyshe. muharremi@g mail.com</a>
19	Drita Feta	Qilimpunuese, 62 vjeç	Kavajë	0676292074
20	Adelina Kaloti	Qëndistare	Kavajë	0698604542
21	Brunilda Çullhaj	Qëndistare, 42 vjeç	Rrogozhinë	0695106233
22	Valeria Gjergji	E re e interesuar për t'u aftësuar si qilimpunuese	Kavajë	N/a
23	Albana Hoxha	E re e interesuar për t'u aftësuar si qilimpunuese	Kavajë	N/a

**ARTIZANATI NË KAVAJË DHE RROGOZHINË**

24	Glejdis Krasnaj	E re e interesuar për t'u aftësuar si qilimpunuese	Kavajë	N/a
25	Franko Kostrista	I ri i interesuar për t'u aftësuar si poçar	Kavajë	N/a
26	Kostandin Kostrista	I ri i interesuar për t'u aftësuar si poçar	Kavajë	N/a
27	Erdi Hoxha	I ri i interesuar për t'u aftësuar si poçar	Kavajë	N/a
28	Besime Baja	E re e interesuar për t'u aftësuar si qëndistare	Kavajë	N/a
29	Jonida Kokoshi	E re e interesuar për t'u aftësuar si qëndistare	Kavajë	N/a
30	Asmeral Laze	E re e interesuar për t'u aftësuar si qëndistare	Kavajë	N/a

## SHTOJCA B: PYETËSORI



### PYETËSOR PËR KRIJIMIN E PROFILIT TË ARTIZANËVE SI DHE VLERËSIMIN E NEVOJAVE TË TYRE

Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) së bashku me Kube Studios po zbatojnë në Bashkinë Kavajë dhe Rrogozhinë projektin “ArtCult - Artizanët për Trashëgiminë Kulturore”, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit “Rikrijo të shkuarën: Ndërto të ardhmen - EU4Culture”, i cili zbatohet nga UNOPS në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Kulturës.

ArtCult synon të ofrojë mbështetje në ruajtjen dhe rijetëzimin e zejeve dhe aftësive artizanale tradicionale që janë në zhdukje, përmirësimin e zejeve ekzistuese, si dhe inkurajimin e mënyrave të reja dhe inovative të krijimit të zanateve, si mundësi për rritje socio-ekonomike në zonat e përzgjedhura.

Ne sigurojmë se do të ruhet anonimat i të dhënave personale të çdo të intervistuarit, ndërsa informacioni që do të merret përmes pyetësorit do të përdoret vetëm për qëllime kërkimore!

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

### TË DHËNAT PERSONALE (OPSIONALE)

1. Emri dhe mbiemri (për qëllim krijimin e profilit të artizanit dhe promovimin e tij):

\_\_\_\_\_

2. Gjinia

- Mashkull
- Femër

3. Grup-mosha

- 18 - 24 vjeç
- 25 - 34 vjeç
- 35 - 44 vjeç
- 45 - 54 vjeç
- 55 - 64 vjeç
- 65+ vjeç

### ARSIMI

4. Niveli i arsimimit

- Arsim bazë
- Arsim i mesëm i përgjithshëm
- Arsim i mesëm profesional
- Arsim i lartë
- Pa përgjigje

Ju lutemi specifikoni fushën e studimit ashtu siç është e dhënë në diploma \_\_\_\_\_

### TË DHËNA MBI PROFESIONIN

5. Çfarë lloj artizanati ushtroni?

- Punimi i gurit – skalitja
- Punimi i argjilës (baltës) - poçeria
- Punimi i metaleve
- Punimi i drurit
- Punimi i fijos – qëndistaria
- Punimi i qelqit
- Punimi i kashtës
- Tjetër, lutem specifikoni

\_\_\_\_\_





Financuar nga  
Bashkimi Evropian



## 6. Prej sa vitesh e ushtroni profesionin e artizanit?

- Më pak se 1 vit
- 1-4 vite
- 5-10 vite
- Më shumë se 10 vite

## 7. Ku e keni mësuar profesionin?

- E kam trashëguar në familje
- E kam mësuar në ndërmarrje artistike
- E kam mësuar në emigracion
- E kam mësuar në kurse të organizuara në qendra profesionale
- E kam mësuar në kurse të organizuar nga shoqata të ndryshme
- Tjetër, lutem specifikoni \_\_\_\_\_

## 8. A jeni i regjistruar si biznes?

- Po
- Jo

## 9. Nëse po, në çfarë statusi jeni i regjistruar?

- I/e vetëpunësuar i vetëm
- Pronar/e, bashkëpronar/e me të punësuar familjarë
- Pronar/e, bashkëpronar/e me të punësuar jofamiljarë

## 10. Sa punonjës me kohë të plotë ose të pjesshme keni gjithsej (përfshi veten tuaj)?

- Vetëm 1, unë (i/e vetëpunësuar)
- 2-3 familjarë
- 2-3 jofamiljarë
- 4-10 të punësuar

## 11. Çfarë përdorni si lëndë të pare për produktet që prodhoni?

\_\_\_\_\_

## 12. Sa të vështirë e keni ta siguron lëndën e parë pranë zonës suaj të banimit?

- Shumë të vështirë
- Të vështirë
- Disi të vështirë
- Pak të vështirë
- Aspak të vështirë

Lutem shpjegoni përgjigjen (tjetër: *ku e siguron si lëndë?*) \_\_\_\_\_

## 13. Ku punoni për prodhimin e produkteve tuaja

- Në ambientin ku banoj
- Tjetër (lutem specifikoni) \_\_\_\_\_
- Në ambient të marrë me qira

## 14. Ku i shisni produktet tuaja?

- Dyqanin tim
- Ambientet e punishtes
- Platforma online
- Tjetër, lutem shpjegoni: \_\_\_\_\_

## 15. A ofroni kurse për fëmijët dhe vizitorët e interesuar?

- Po
- Jo



16. A keni trajnuar të tjerë mbi teknikat e profesionit që zotëroni?

- Po
- Jo

17. Në hapësirën ku punoni, a keni mjaftueshëm hapësirë dhe vegla pune për 3-5 persona?

- Po
- Jo

18. Cilat janë produktet më të kërkuara që krijoni?

---

---

19. A i keni të ndara përgjegjësitë në biznesin tuaj (prodhimi i produkteve, marketingu, shitjet, etj.)?

- Merrem vetë me gjithçka
- I kam ndarë me familjarë
- Për marketingun dhe shitjet bashkëpunoj me profesionistë të fushave
- Tjetër, lutem shpjegoni: \_\_\_\_\_

20. Cila është baza e modelit të produkteve që prodhoni?

- Model i trashëguar
- Modele të krijuara vetë
- Modele të "kopjuara" nga interneti
- Modele të 'kopjuara' nga artizanë vendas
- Tjetër, lutem specifikoni: \_\_\_\_\_

21. A ju shqetëson kopjimi nga artizanë të tjerë i produkteve që keni krijuar vetë?

- Po
- Jo
- Nuk më ka ndodhur të kopjohen

22. A ju shqetëson konkurrenca e produkteve industriale të importit?

- Po
- Jo

23. Në promovimin e punës apo biznesit tuaj, cilën formë komunikimi përdorni?

- Faqe interneti të biznesit
- Facebook
- Instagram
- LinkedIn
- Tjetër: \_\_\_\_\_
- Nuk e promovoj punën

24. Cilat janë problemet më të mëdha me të cilat haseni (zgjidhni deri në tre alternativa)

- Mungesa e lëndës së parë
- Mungesa e një ambienti/punishte pune
- Mungesa e një tregu të përhershëm shitjeje sa më pranë konsumatorëve
- Mungesa e panairëve për promovimin e punimeve
- Politikat shtetërore të taksimit
- Mungesa e trajnimeve për menaxhimin e biznesit
- Mungesa e subvencioneve, kredive, granteve
- Gjetja e stafit të kualifikuar
- Tjetër, lutem specifikoni: \_\_\_\_\_

25. Çfarë njohurish dhe aftësish të reja do të lehtësonin menaxhimin e biznesit apo mbarëvajtjen e punës suaj?

- Njohuri mbi marketingun online
- Menaxhimi i rrjeteve sociale

- Aftësimi në realizimin e fotografive/videove për promovimin e produkteve
  - Menaxhimi i shitjeve
  - Dizajnimi i produkteve artizanale duke marrë parasysh tendencat bashkëkohore modern
  - Njohja me konceptin e laborator turizmi/turizmi eksperiencial
  - Tjetër, lutem specifikoni:
- 

**26. Sa i nevojshëm është ofrimi i kurseve për aftësimin e të rinjve mbi realizimin e punimeve artizanale tradicionale?**

- Shumë i nevojshëm
- I nevojshëm
- Disi i nevojshëm
- Pak i nevojshëm
- Aspak i nevojshëm

**SHTOJCA C: PERSONAT E INTERVISTUAR**

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni
1	Ligor Kostrista	Artizan, poçar
2	Luçie Hoxha	Qilimpunuese
3	Myrvete Topi	Qëndistare
4	Ismete Shaba	Qilimpunuese
5	Ferid Qarri	Teneqepunues
6	Gjini Hoxha	Qilimpunuese
7	Lulëzime Krasnaj	Qëndistare
8	Brunilda Cllhaj	Qëndistare
9	Stefanaq Sotja	Përgjegjës, Muzeu Etnografik Kavajë
10	Xhemile Uku	Bashkia Rrogozhinë

## REFERENCAT

Bonetti, E., Simoni, M., & Cercola, R. (2014). Creative tourism and cultural heritage: A new perspective. In Handbook of Research on Management of Cultural Products: E-Relationship Marketing and Accessibility Perspectives (pp. 367-395).

Gjepali, I. 2005. Kërkime survey në Degën Jugore të Via Egnatias.

Lazi, 2021. Kavaja: Historia, Kultura, Turizmi. Albanian CRI. Marrë nga: <https://albanian.cri.cn/culture/more/3104/20210125/61095.html>

Monitor. 2012. Pak krijues. Marrë nga: <https://monitor.al/pak-krijues/>

Projekti Rrënjët e mia-Kulturë 360. 2021. Marrë nga: <https://rrenjetemia.al/>

Statista Research Department. 2023. Social media platforms used by marketers worldwide 2022. Marrë nga: <https://www.statista.com/statistics/259379/social-media-platforms-used-by-marketers-worldwide/>

UNESCO Creative Cities Network. 2006. Towards Sustainable Strategies for Creative Tourism: Discussion Report of the Planning Meeting for 2008 International Conference on Creative Tourism.

United States Securities and Exchange Commission. 2022. Commission File Number 001-36911.

Zaidi, T. 2021, Airbnb Experiences Explained. TRVLGuide. Marrë nga: <https://trvlguides.com/articles/airbnb-experiences>